



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
ASAMBLEJA**



STATUTI

I AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË



Tiranë, 2019

Me ndryshimet e bëra nga ligji nr. 69/2023, datë 21.07.2023

Ndryshuar me Vendimin e Asamblese nr.17, dt. 21.02.2020

Ndryshuar me Vendimin e Asamblesë nr.47, dt.21.07.2021

Ndryshuar me Vendimin e Asamblesë nr. 1, dt. 09.01.2024

Ndryshuar me Vendimin e Asamblesë nr. 21, datë 23.02.2024

Ndryshuar me Vendimin e Asamblesë nr. 12, datë 28.02.2025

Miratuar me Vendimin e Asamblesë së ASH nr.22, datë 18 tetor 2019

Asambleja e ASH-së, në mbledhjen e saj të datës 18 tetor 2019 në zbatim të nenit 24 të ligjit 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë” miratoi Statutin si vijon:

I DISPOZITAT KRYESORE

Neni 1 Objekti / qëllimi

Ky statut ka për qëllim të përcaktojë rregullat, procedurat dhe kriteret më të hollësishme për funksionimin e ASH-së e të organeve dhe strukturave të saj, në zbatim të ligjit të ASH-së e në plotësim të tij, si dhe legjitimitimin e rregulloreve të brendshme të dala në bazë të këtij Statuti.

Veprimtaria e Akademisë mbështetet te Kodi i Etikës i ALLEA-s, përshtatur e pasqyruar te pjesa e këtij statuti “Për kodin e sjelljes me integritet në kërkimin shkencor”.

Neni 2 Akademia

1. Akademia është institucion publik, përfaqësuesi më i lartë i shkencës e i kërkimit shkencor në vend, që vepron përmes një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh.
2. Akademia është institucion autonom në fushën e kërkimit, që e mbështet veprimtarinë e saj në prova shkencore dhe në dobi të vendit.
3. Akademia, si person juridik, është trupa e shkencëtarëve dhe e kërkuesve, që në këtë Statut do të quhet Asamble.
4. Selia e Akademisë është në Tiranë. Ajo ka stemën dhe logon e vet, sipas **aneksit 1**.

Neni 3 Përbërja e Akademisë

Akademia si institucion përfshin:

- Organet e saj drejtuese (Asamblenë, Kryesinë, Kryetarin);

- Strukturat e ngritura në përbërje a pranë saj (seksionet, komisionet, njësitë e kërkim-studimit, Akademinë e të Rinjve, bibliotekën, entin botues, si dhe një administratë ndihmëse).

Neni 4

Roli dhe funksionet kryesore

1. Të pranojë si anëtarë në radhët e saj dijetarë, krijues e kërkues të shquar në fushën e shkencës e të kulturës, të cilët përmbushin standarde të larta në lidhje me personalitetin, punën dhe reputacionin në shkencë e në kulturë.
2. Të kontribuojë, të promovojë e të vlerësojë më mirë arritjet e kërkimit shkencor dhe të propozojë fusha të reja kërkimore e studimore në përputhje me përparësitë e nevojat e zhvillimit të vendit.
3. Të ndërtojë strategji dhe të zbatojë politika për përdorimin e njësuar të gjuhës shqipe zyrtare, të terminologjive bashkëkohore të shkencës dhe teknikës, si dhe për konsolidimin e gjuhës shqipe në të gjitha fushat e shkencës.
4. Të këshillojë e të ndihmojë me rekomandime, ekspertiza e opionenca Qeverinë dhe institucionet qendrore për aspekte të rëndësishme të kërkimit shkencor, të formimit të specialistëve të lartë e të brezave të rinj dhe të planifikimit të projekteve të së ardhmes.
5. Të kontribuojë në promovimin dhe mbështetjen e vazhdueshme të shkencëtarëve të rinj.
6. Të nxisë dhe të udhëheqë krijimin e njërive të veçanta të kërkimit, si dhe të hartimit të strategjive të zhvillimit të shkencës e të kërkimit shkencor.
7. Të promovojë, të botojë dhe të shpërndajë standardet e reja ndërkombëtare të kërkimit shkencor dhe të inovacionit, si dhe të garantojë respektimin e tyre për vlerësimin e punës shkencore dhe etikës në shkencë, si dhe për mbështetjen e programeve të studimit apo kërkimit.
8. Të botojë organe periodike, revista dhe vepra të tjera me nivel të lartë ndikimi shkencor.
9. Të bashkëpunojë me institucionet e vendit me kapacitet kërkimi, si: institucionet e arsimit të lartë, institutet dhe qendrat e kërkimit; me qëllim bashkërendimin e kërkimit shkencor dhe përgatitjen e kërkuesve të rinj.
10. Të bashkëpunojë me institucionet analoge jashtë vendit për promovimin e arritjeve e për tërheqjen e projekteve të përbashkëta, për diplomacinë shkencore dhe për të përfaqësuar në shkallë ndërkombëtare komunitetin shkencor shqiptar.
11. Të organizojë kongrese, konferenca e simpoziume shkencore në shkallë kombëtare e ndërkombëtare.

12. Të ruajë, të dokumentojë dhe të përcjellë trashëgiminë akademike, përmes botimeve përmbledhëse të veprave të figurave më të spikatura, përmes zhvillimit të aktiviteteve, ekspozitave dhe muzeve të ngritura në përputhje me legjislacionin përkatës.
13. Të propozojë metoda e kriteret për matjen dhe vlerësimin objektiv të cilësisë dhe ndihmesave në procesin e kërkimit shkencor pranë ministrisë përkatëse, komisionit të Kuvendit apo Këshillit të Ministrave.
14. Të orientojë fushat dhe nënfushat parësore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për shkencën, për kërkimet shkencore të doktoratës. Të analizojë arritjet dhe problematikat e këtyre kërkimeve dhe të hartojë çdo dy vjet një raport publik për to.
15. Të inkurajojë si përparësi të kërkimit shkencor zhvillimin e programeve të studimit me karakter ndërdisiplinor dhe të mbrojë deontologjinë e tij.
16. Të promovojë identitetin kombëtar nëpërmjet përafrimit gjithmonë e më të ngushtë me akademitë shqiptare në rajon.
17. Të ndërtojë strategji dhe të zbatojë politika për zhvillimin e shkencave albanologjike dhe për promovimin e arritjeve të tyre brenda dhe jashtë vendit.
18. Të sigurojë që zgjedhja e anëtarëve të Asamblesë të zhvillohet në përputhje me parimin e barazisë gjinore, duke synuar progresivisht balancën gjinore të përfaqësimit.

Neni 5

Anëtarët e Akademisë

Anëtarët e zgjedhur sipas këtij statuti *quhen* anëtarë të Akademisë së RSH-së, që përbëhet nga anëtarët e Asamblesë, anëtarët e jashtëm dhe anëtarët e nderit. Anëtarët e Asamblesë fitojnë titujt “akademik” dhe “akademik i asociuar”.

Neni 6

Detyrat e përgjithshme të anëtarëve të Akademisë

1. Të zgjedhin e të zgjidhen në organet drejtuese e në strukturat në përbërje e pranë Akademisë.
2. Të marrin pjesë aktive në mbledhjet e Asamblesë, të seksioneve e të komisioneve. Mospjesëmarrja në to duhet të jetë e justifikuar, për arsye objektive. Për mospjesëmarrje të paarsyeshme, për periudha mbi 6 muaj, Kryesia përcakton penaltete financiare me ndalesa të pagesës për titull deri në 2 muaj, ndërsa për periudha mbi 12 muaj kjo masë shoqërohet edhe me pezullim të së drejtës së votës.
3. Të luajë rol aktiv në nxitjen e promovimin e shkencës e të kërkimit shkencor në institucionet ku punojnë a në fushën përkatëse.

4. Të zbatojë detyrat e marra nga Asambleja, Kryesia, Kryetari, kryetarët e seksioneve ose komisioni përkatës.
5. Të marrin pjesë aktive në kongreset, konferencat e veprimtaritë zyrtare të Akademisë e të organeve të saj, si dhe në ato rajonale dhe ndërkombëtare.
6. Të kërkojnë e të marrin informacion për punën shkencore, planet e programet e përgatitura nga institucionet e arsimit të lartë dhe nga institucionet kërkimore për fushën që mbulojnë. Çdo kërkesë e tillë bëhet nëpërmjet Sekretarit Shkencor të ASH-së pranë institucionit përkatës, i cili e përcjell atë brenda 7 ditëve.
7. Të japin ekspertizë e këshillime për institucionet shtetërore e ato publike të shkencës e të arsimit.
8. Të marrin pjesë në njësitë ose grupet e punës për studimin, hartimin ose kërkimin në fusha të caktuara.
9. Të përfaqësojnë ASH-në në komisione, borde e këshilla ekspertize me karakter ndërinstitutional.

II

ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË AKADEMISË

Neni 7

Anëtarët e Asamblesë

1. Asambleja e ASH-së ka në përbërje të saj deri në 30 anëtarë që mbajnë titullin “akademik” dhe deri në 10 anëtarë që mbajnë titullin “akademik i asociuar”, si dhe anëtarët “Emeritus”, të zgjedhur sipas këtij statuti nga trupa e shkencëtarëve, kërkuesve e krijuesve më të spikatur.
2. Anëtarët e Asamblesë zgjidhen ndër mbajtësit e titullit “profesor” me banim të përhershëm brenda vendit, që kanë ndihmesa të shquara në fushën përkatëse dhe, në raste të veçanta, personalitete me kontribut të spikatur me jehonë kombëtare e më gjerë nga fusha e krijimtarisë artistike, kulturës dhe e jetës sociale në tërësi.
3. Vendet e lira për të kandiduar përcaktohen nga Asambleja me propozim të Kryesisë, pas konsultimeve me seksionet e komisionet përkatëse, duke pasur parasysh vendet e lira të krijuara, si dhe mbajtjen e një raporti të arsyeshëm përfaqësimi, midis fushave dhe nënfushave të zhvillimit të shkencës e të kërkimit shkencor. Për efekt të përmirësimit të balancës gjinore, në bazë të pikës 18, të nenit 4, të ligjit për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë, mund të përcaktohen vende të veçanta për gjininë më pak të përfaqësuar, duke respektuar kriteret e cilësisë sipas këtij statuti.
4. Shpallja e vendeve të lira bëhet publike dhe i dërgohet IAL-ve e instituteve kërkimore 6 muaj para votimit. Ajo shoqërohet me afatet konkrete për tërë fazat kryesore të kandidimit deri në

zgjedhje, të cilat përfshijnë: paraqitjen e interesit për kandidim, kohën e shqyrtimit në organet këshillimore; paraqitjen në komisionin dhe seksionin përkatës dhe koha e votimit në Asamble.

5. Kandidimi bëhet nga çdo i interesuar, me mbështetjen e dy akademikëve ose dy ekspertëve, me së paku me gradën “doktor i shkencave”.
6. Me paraqitjen e interesit verifikohet plotësimi i kriterëve të normuara në ligjin e Akademisë së Shkencave e në këtë statut, si dhe në ligjet nr. 138/2015 dhe nr.45/2015 nga një komision teknik i ngritur nga Kryesia. Kriteri moshor llogaritet sipas procedurës së përdorur në nenin 9, të këtij statuti.

Në rast të mospërbushjes së njërës prej tyre, njoftohet shkualifikimi.

7. Më tej verifikohen kriteret e veçanta, që duhet të plotësojnë kandidatët, sipas parashikimeve të **aneksit 2**.
8. Mospërbushja e kriterëve të mësipërme, të karakterit detyrues, përbën shkak për propozim të eliminimit të kandidatit, ndërsa për shkallën dhe nivelin e përbushjes së tyre, që përbëjnë arsyen kryesore për shanset e zgjedhjes së çdo kandidati, shprehet seksioni me vendim. Mbledhjet e Seksionit bëhen të hapura, ku, pasi dëgjohet mendimi i propozuesve e i senatit, si dhe vlerësimet e komisionit, dëgjohet vetë kandidati. Seksioni merr vendim me votë të fshehtë. Në rast të disa kandidaturave për të njëjtin post, ato renditen sipas votave “pro” të fituara.
9. Pas shprehjes me vendim të seksioneve për çdo kandidat, kandidaturat paraqiten nga Kryetari për votim në Asamble. Çdo kandidaturë shoqërohet me tërë vlerësimet e përmbledhura të organeve që janë shprehur për ta, si dhe me listën e veprimtarisë së plotë të kandidatit.
10. Për kandidatët me titull “akademik i asociuar”, që kandidojnë për titullin “akademik”, vlerësohet posaçërisht veprimtaria gjatë kësaj periudhe, bazuar në kriteret e **aneksit 2**, çka bëhet drejtpërdrejt nga komisioni dhe Seksioni, si më lart.
11. Kandidatët që konkurrojnë për “akademikë të asociuar”, ose kandidatët që janë tashmë “akademikë të asociuar” dhe kandidojnë për “akademikë”, zgjidhen në rast se fitojnë mbi 50% të numrit të anëtarëve të Asamblesë, minus anëtarët “Emeritus” jopjesëmarrës në votim. Ndërsa kandidatët që konkurrojnë drejtpërdrejt për “akademikë”, quhen fitues kur marrin 2/3 të votave të sa më sipër.
12. Kur për të njëjtin vend paraqiten më shumë se një kandidat, atëherë fituesi përcaktohet sipas formulës në **aneksin 3** të këtij statuti.

Nuk mund të zgjidhen anëtarë të Asamblesë, pa dhënë dorëheqjen: titullarët e institucioneve kushtetuese, kryetarët dhe sekretarët e përgjithshëm të partive politike, apo ekuivalentët me ta.

Anëtarët e zgjedhur, sipas këtij neni, gëzojnë të gjitha të drejtat dhe detyrat e nenit 6 dhe ato të parashikuara në këtë statut.

Neni 8
Anëtarët nga radhët e personaliteteve
të fushës së krijimtarisë artistike, të kulturës dhe të jetës sociale

1. Anëtarë të Asamblesë, në raste të veçanta, zgjidhen edhe personalitete me ndihmesë të spikatur nga fusha e krijimtarisë artistike, kulturës dhe jetës sociale në përgjithësi.
2. Kandidati/tët propozohen nga Kryesia, nga Seksioni apo nga institucionet shtetërore të artit dhe kulturës, si dhe nga shoqatat e krijuesve. Për verifikimin e kriterëve të normuara veprohet si në pikën 6, të nenit 7. Për ta nuk kërkohet mbajtja e titullit “profesor”. Më tej bëhet shqyrtimi i kandidaturave në seksionin përkatës ku paraqitet edhe arsyetimi i propozuesit, 2 recensa për dy veprat kryesore, si dhe dëgjimi i kandidatit. Vendimi merret duke u bazuar në vlerësimin e kriterëve sipas Aneksit 2.
3. Anëtarët që zgjidhen nga radhët e personaliteteve, gëzojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet si anëtarë të Asamblesë.

Neni 9
Anëtarët “Emeritus”

1. Çdo anëtar Asambleje, pas mbushjes së moshës 75 vjeç, fiton statusin e anëtarit “Emeritus” sipas nenit 6, pika 4 të ligjit 53/2019.
2. Ky Status i fillon efektet më 1 janar të çdo viti, për anëtarët që kanë mbushur këtë moshë në 6-mujorin e parë të vitit paraardhës dhe më 1 korrik për ata që kanë mbushur moshën në 6-mujorin e dytë të vitit paraardhës. Kjo shpallet me vendim qarkullues të Asamblesë, 1 (një) muaj para afateve të mësipërme.
3. Anëtarët “Emeritus” gëzojnë gjithë të drejtat dhe detyrimet si anëtarë Asambleje, përveç së drejtës për t’u zgjedhur në organet drejtuese.
4. Për sa i takon pjesëmarrjes në aktivitetet e Akademisë dhe strukturave pranë saj, pjesëmarrja e tyre është sipas mundësive dhe nuk penalizohen sipas pikës 2, neni 6, ndërsa për detyrat e marra, ata mbajnë përgjegjësi si të gjithë anëtarët e tjerë.

Neni 10
Anëtarët e jashtëm

1. Kandidatët për anëtarë të jashtëm propozohen nga Kryetari, dy akademikë apo një komision.
2. Kandidatët për anëtarë të jashtëm duhet të plotësojnë kriteret e parashikuara në ligj, të cilat verifikohen nga një komision teknik. Mosplotësimi çon në eliminimin e kandidatëve.

3. Pas verifikimit të plotësimit të kriterëve specifike të parashikuara në **aneksin 2**, sipas procedurave të tij, kandidatura shqyrtohet në Seksion dhe votohet në Asamble. Procedurat e mëtejshme janë si për anëtarët e Asamblesë.
4. Asambleja zgjedh edhe anëtarë të jashtëm ndër personat me shtetësi apo origjinë shqiptare me banim jashtë vendit, figura të shkencës e të kulturës, si dhe anëtarë nderi ndër figurat e shkencës e të kulturës që janë shtetas joshqiptarë me banim jashtë vendit, të cilët me punimet e tyre kanë ndikuar në ecurinë e mendimit e të zbatimit të shkencës në Shqipëri apo në promovimin e të vërtetave dhe të vlerave të origjinës, gjuhës e kulturës shqiptare.
5. Anëtar i jashtëm zgjidhet edhe çdo person me shtetësi apo origjinë shqiptare me banim të përhershëm jashtë vendit, që tashmë është anëtar i një akademie simotër, anëtare e ALLEA-s, i cili ka ndihmesa të spikatura në fushën e vet të kërkimit. Për ta kërkesat e **aneksit 2**, quhen të plotësuara.
6. Pranimi i tyre bëhet në bazë të propozimit të kryesisë apo një seksioni dhe me pëlqimin e të interesuarit. Votimi bëhet i hapur, në një seancë me karakter ceremonial.
7. Anëtarët e jashtëm kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë pa të drejtë vote, si dhe në gjithë aktivitetet e Akademisë*. Me pëlqimin e tyre, ata aktivizohen dhe kontribuojnë në plotësimin e detyrave të Akademisë dhe anëtarëve të saj, të përcaktuara në nenet 4 dhe 6 të këtij statuti.

Neni 11

Anëtarët e nderit

1. “Anëtar nderi” zgjidhet çdo shtetas i huaj me banim të përhershëm jashtë vendit, i cili me punimet e tij ka ndikuar në ecurinë e mendimit e të zbatimit të shkencave në Shqipëri apo në promovimin e të vërtetave dhe të vlerave të origjinës, së gjuhës e të kulturës shqiptare.
2. Kandidatët për anëtar nderi propozohen nga Kryesia, Seksioni përkatës apo dy institucione të arsimit të lartë të kërkimit në vend.
3. Seksioni përkatës vlerëson e shprehet për propozimin, pasi dëgjon dy referencat, ku pasqyrohet plotësimi i një apo disa prej kriterëve specifike të parashikuara në **aneksin 2**. Pas kësaj shprehen seksionet e tjera për mbështetjen e kandidaturës.
4. Kur vlerësimi është pozitiv nga ana e të gjitha seksioneve, kandidatura i kalon Asamblesë. Votimi për anëtarët e nderit bëhet i hapur, në një seancë ceremoniale.
5. Anëtarët e nderit kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë pa të drejtë vote, si dhe në të gjitha aktivitetet e Akademisë. Me pëlqimin e tyre, ata aktivizohen e kontribuojnë në plotësimin e detyrave të ASH-së dhe anëtarëve të saj të përcaktuara në nenet 4,6 të këtij statuti.

* Ndryshuar me ligjin nr. 69/2023, hequr neni 10 i mëparshëm, zhvendosur nenet e tjera.

Neni 12

Ndërprerja e mandateve si anëtarë dhe humbja e titullit

Mandati i anëtarit të Akademisë përfundon, kur:

1. *Jep dorëheqjen.* Dorëheqja i paraqitet Kryesisë, e cila e formalizon atë brenda 5 ditësh dhe informon Asamblesë, seksionin dhe komisionin përkatës.
2. *Për komprometim të rëndë të figurës së akademikut, për shkelje të “Kodit të etikës e të kërkimit shkencor”.* Në këtë rast propozimi për ndërprerje mandati bëhet nga 5 anëtarë të Asamblesë, ose një seksion, ose nga Kryesia. Në rastet e para, kërkesa i paraqitet Kryesisë me arsyet pse kërkohet kjo masë. Brenda 10 ditëve bëhet dëgjimi i të interesuarit në Kryesi (ose në seksion kur propozimi vjen nga Kryesia). Më tej kërkesa i paraqitet Asamblesë në mbledhjen më të afërt, e cila vendos sipas pikës b, neni 16 i ligjit. Në rastin kur shkelja është objekt i procedimit penal, atëherë Kryesia mund të kërkojë pezullimin e mandatit, deri në vendimin e Gjykatës të formës së prerë. Kur personi dënohet për kryerjen e një vepre të rëndë penale, atëherë i propozohet Asamblesë ndërprerja e mandatit dhe /ose heqja e titullit.
3. *Për shkaqe të veçanta, të përcaktuara në legjislacion (Ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”), si ndalesë për të ushtruar funksionin e anëtarit të Akademisë si funksion publik.* Në këto raste, me konstatimin e faktit, Kryesia, pasi ia bën të ditur personit përkatës, i kërkon dhënien e dorëheqjes. Në rast mospranimi të dorëheqjes, kërkesa i paraqitet Asamblesë me relacionin përkatës. Për shkaqe të arsyetuara mund të kërkohet verifikimi i mëtejshëm, kryesisht apo me kërkesë të të interesuarit. Verifikimi ribëhet brenda 2 muajve.
4. *Për pamundësi të ushtrimit të funksionit.* Në këtë rast me propozim të komisionit apo seksionit përkatës, Kryesia i propozon Asamblesë ndërprerjen e ushtrimit të mandatit, por jo heqjen e titullit.
5. Për rastet 2) e 3) Asambleja vendos ndërprerje mandati si anëtar i Asamblesë dhe heqje titulli ose vetëm ndërprerje mandati.
6. Për anëtarët e jashtëm ose ata të nderit *pamundësi ushtrimi* do të konsiderohet mungesa e interesimit të anëtarit përkatës për 3 vjet me radhë, ndaj mandatit të fituar si anëtar Akademie, për të cilat ndiqet e njëjta procedurë si në pikën 4. Propozimet për këtë bëhen nga seksionet, të cilat, nëpërmjet Kryesisë, i kalojnë Asamblesë. Bazuar në to, Asambleja merr vendimin për përfshirjen e anëtarëve në listën pasive, pjesëtarët e së cilës nuk i gëzojnë më të drejtat e parashikuara në këtë statut.

III ZGJEDHJA E KRYESISË

Neni 13 Përbërja e Kryesisë

Kryesia e ASH-së përbëhet nga Kryetari, Zëvendëskryetari, Sekretari Shkencor, kryetarët e seksioneve.

Neni 14 Zgjedhja e Kryetarit

Kryetari i Akademisë zgjidhet ndër anëtarët e Asamblesë me titullin “akademik”.

Kandidimi është i lirë dhe bëhet ose nga vetë personi, ose me propozim të 3 anëtarëve të Asamblesë (jo më shumë).

Dita e votimit caktohet 30 ditë para mbarimit të mandatit të Kryetarit paraardhës, ose brenda 60 ditëve nga krijimi i mungesës sipas nenit 16, të ligjit 53/2019 dhe nenit 21 të këtij statuti.

Çdo kandidat depoziton dokumentet e kandidimit pranë një komisioni teknik, të ngritur posaçërisht nga Kryesia, i cili bën verifikimin e plotësisë të kushteve ligjore të kandidimit.

Neni 15 Dokumentet e kandidimit

Kandidati për Kryetar duhet të paraqesë:

1. Kërkesën për kandidim ose pranimin e propozimit për kandidim me firmat mbështetëse.
2. Një platformë personale për drejtimin e ASH-së në 4-vitet e ardhshme.
3. Curriculum Vitae të shoqëruar me aktivitetin e tij akademik, posaçërisht me listën e plotë të botimeve shkencore.
4. Formularët për verifikim të figurës dhe për dekriminalizimin.
5. Dorëheqjen nga postet e: kryetarit a anëtarit në organet drejtuese të një partie politike; të titullarit a zëvendësit të tij në institucionet kushtetuese, në rast se mban një të tillë.

Neni 16 Votimi

1. Mbledhjen për zgjedhjen e Kryetarit të ri, e hap dhe e drejton Kryetari i ASH-së ose, me pëlqimin e tij, një ndër akademikët më të moshuar.

2. Pas verifikimit të kuorumit për praninë, sipas nenit 8, pika 4, të ligjit nr.53/2019, pikës 2, neni 25, i këtij statuti dhe të pjesëmarrjes në votim, që duhet të jetë jo më pak 2/3 e anëtarëve (përfshirë edhe votuesit në distancë), ngrihet komisioni zgjedhor me 3 ose 5 anëtarë.
3. Paraprakisht bëhet i njohur plotësimi i kriterëve ligjore të kandidatëve, sipas relacionit të komisionit teknik, dhe lista e anëtarëve të Asamblesë, që votojnë në distancë. Pas paraqitjes së kandidaturave dhe të platformave përkatëse, komisioni zgjedhor drejton procesin e votimit deri në shpalljen e rezultatit.
4. Procesi i votimit bëhet pa debat.

Neni 17

Rezultatet e votimit

1. Kandidati përkatës është fitues, kur për të kanë votuar “pro” mbi 50% e numrit të anëtarëve të Asamblesë.
2. Kur, për zgjedhjen e Kryetarit janë paraqitur dy kandidatë, atëherë fitues quhet kandidati që ka marrë që në raundin e parë mbi 50% të votave të anëtarëve të Asamblesë, si më lart, në rast se jo, atëherë fiton ai prej kandidatëve që në raundin e dytë ka marrë mbi 50% të votave të votuesve gjithsej, sipas procedurës së përcaktuar në **aneksin 3**.
3. Kur paraqiten mbi dy kandidatura, atëherë me votën e raundit të parë përcaktohet renditja e kandidatëve. Në rast se i pari është votuar “pro” nga mbi 50% e anëtarëve të Asamblesë, atëherë ai është fitues. Në rast se jo, fituesi përcaktohet në bazë të votave të raundit të dytë, sipas procedurave të **aneksit 3**.

Neni 18

Emërimi i Kryetarit

1. Kryetari i zgjedhur i ASH-së i dërgohet për emërim Presidentit të Republikës, brenda 3 ditëve. Presidenti i Republikës, brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës, emëron Kryetarin e zgjedhur.
2. Kur Presidenti i Republikës vendos mosemërimin e Kryetarit të zgjedhur, dekreti i Presidentit e humbet fuqinë nëse nuk mbështetet nga shumica e të gjithë anëtarëve të Asamblesë. Për këtë Asambleja shprehet në një mbledhje të posaçme, ku votohet pa debat, pasi njihet paraprakisht me arsyet e refuzimit dhe me vlerësimin e Kryesisë për to.
3. Në këtë rast, si dhe kur Presidenti nuk shprehet, Kryetari i zgjedhur shpallet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 7 ditëve nga vendimi i Asamblesë ose nga mbarimi i afatit të pikës 1 të këtij neni. Para fillimit të detyrës duhet të ndërpresë çdo funksion a detyrë tjetër me kohë të plotë.

Neni 19

Zgjedhja e anëtarëve të Kryesisë

1. Për zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë ndiqen të njëjtat kritere e procedura si për Kryetarin, përveç detyrimit për të paraqitur platformë.
2. Në vend të saj kandidati mund të paraqesë vizionin e tij ndaj platformave të paraqitura nga kandidatët për Kryetar. Disa kandidatë mund të paraqesin edhe platformë të përbashkët.
3. Anëtar Kryesie mund të zgjidhet çdo anëtar i Asamblesë, që ka të drejtën për t'u zgjedhur, përveç zëvendëskryetarit, që duhet të jetë me titull “akademik”. Papajtueshmëritë për ta janë njëlloj si për Kryetarin.
4. Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe anëtarët e Kryesisë zgjidhen nga Asambleja me votim të fshehtë dhe të drejtpërdrejtë me shumicën absolute të votave të vlefshme të anëtarëve të Asamblesë.

Neni 20

Vlefshmëria e mandateve

Mandati i Kryetarit dhe i zëvendëskryetarit është 4 vjet, ndërsa ai i sekretarit shkencor dhe i drejtuesve të seksioneve është 5 vjet.

Kryetari, zëvendëskryetari, sekretari shkencor dhe drejtuesit e seksioneve mund të rizgjidhen në të njëjtin funksion për dy mandate*.

Neni 21**

Ndërprerja e mandateve

Mandati i anëtarit të Kryesisë ndërpritet, kur:

- 1) *Jep dorëheqjen.* Në këtë rast Kryesia formalizon dorëheqjen brenda tri ditësh ose në një datë të rënë dakord. Ky vendim i bëhet i njohur Asamblesë menjëherë.
- 2) *Në rastin e kandidimit në një nga postet e pikës 5,* të nenit 15, të këtij statuti, Kryesia vendos pezullimin e mandatit, ndërsa me zgjedhjen apo emërimin, vendos ndërprerjen e tij.
- 3) *Për shkelje të rënda në ushtrim të detyrës.* Në këtë rast Kryesia ose $\frac{1}{4}$ e anëtarëve paraqet një mocion me arsyet e shkarkimit. Anëtar i Kryesisë ose çdo 5 anëtarë të Asamblesë mund të kërkojnë verifikime më të plota të shkeljeve. Pas kësaj thirret mbledhja e Asamblesë, së cilës një javë para mbledhjes i paraqitet kërkesa për shkarkimin dhe shkaqet pse kërkohet ky

* Ndryshuar me ligjin nr. 69/2023.

** Ndryshuar me ligjin nr.69/2023, hequr ish pika 2.

shkarkim. Anëtari ka të drejtë të paraqesë më parë me shkrim e gjatë mbledhjes (me gojë) kundërshtimet e tij. Më pas bëhet votimi.

- 4) Në rastet 1) anëtari ftohet të ushtrojë detyrën deri në zgjedhjen e anëtarit të ri, por për një periudhë jo më shumë se 3 muaj. Përndryshe, si dhe në rastet 2), 3) në vend të tij komandohet një tjetër për të njëjtën periudhë kohore.
- 5) Kryetari i ASH-së vazhdon detyrën deri në zgjedhjen e të riut, në rastin 1) dhe 2), ndërsa në rastet e tjera detyra e tij ushtrohet nga zëvendëskryetari, për jo më shumë se tre muaj.

IV

Drejtimi i Akademisë

Neni 22

Organet drejtuese

Organet drejtuese të ASH-së janë:

1. Asambleja
2. Kryesia
3. Kryetari

Neni 23

Asambleja

Asambleja është organi më i lartë drejtues i ASH-së, i cili: shqyrton e miraton drejtimit kryesore të veprimtarisë së ASH-së; nxjerr detyra për Kryesinë e Kryetarin, shqyrton e miraton aktet kryesore të organizimit e funksionimit të ASH-së apo strukturave pranë saj, si dhe miraton rregulloret bazë, sipas përcaktimeve në këtë statut.

Neni 24

Detyrat kryesore të Asamblesë

Asambleja kryen këto detyra kryesore:

1. Zgjedh anëtarët e Akademisë;
2. Zgjedh kryetarin, zëvendëskryetarin, sekretarin shkencor dhe drejtuesit e seksioneve.
3. Miraton projektbudgetin vjetor, pas përgatitjes së tij nga Kryesia, dhe ia dërgon Kuvendit për miratim.
4. Miraton raportin vjetor të veprimtarisë së Akademisë për vitin përmbyllës pas përgatitjes së tij nga Kryesia.

5. Miraton programin e punës për vitin pasardhës, si dhe programet afatgjata e strategjitë e zhvillimit.
 6. Miraton statutin dhe ndryshimet e tij me 2/3 e votave.
 7. Miraton marrëveshjet, që nënshkruan Akademia me të tretët, sipas përcaktimeve në këtë statut.
 8. Përcakton llojet e çmimeve shkencore dhe kriteret e dhënies së tyre.
 9. Miraton aderimin e Akademisë në organizata apo bashkime ndërkombëtare me natyrë shkencore.
- Kryen edhe çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga statuti.

Neni 25

Mbledhjet e Asamblesë

1. Asambleja, si rregull, mbledhet dy herë në vit. Ajo thirret edhe në mbledhje të posaçme sipas përcaktimeve në këtë statut.
2. Mbledhjet quhen të rregullta kur thirren sipas këtij statuti dhe kur marrin pjesë në të mbi ½ e anëtarëve të Asamblesë, *kuorum*, i cili llogaritet në bazë të numrit të anëtarëve të Asamblesë gjithsej, minus numrin e anëtarëve “Emeritus” jopjesëmarrës në mbledhjen përkatëse. Formulë që shërben si bazë edhe në llogaritjen e shumicave të cilësuar.
3. Vendimet e Asamblesë merren kur për çështjen konkrete, voton "pro" mbi 50% e pjesëmarrësve në votim, përveç kur në këtë statut parashikohet ndryshe.
4. Votimi bëhet i fshehtë për zgjedhjen e anëtarëve të Asamblesë e të Kryesisë.
5. Anëtarët, për arsye të përcaktuara në këtë statut, mund të votojnë edhe në distancë, elektronikisht apo me postë. Për çështje jozgjedhore vota shoqërohet me një arsyetim të shkurtër, me shkrim, të votës “pro” ose “kundër” që i paraqitet Asamblesë.
6. Lista e personave që do të votojnë si më sipër, i bëhet e njohur Asamblesë, një javë para mbledhjes.
7. Pjesëmarrësit në votim, në distancë, nuk llogariten në plotësimin e kuorumit të hapjes së mbledhjes.

Neni 26

Vendimet qarkulluese

1. Asambleja mund të marrë edhe vendime qarkulluese, si rregull, për çështje urgjente dhe që kanë më shumë rol këshillues e ratifikues, si: për të përcaktuar një reagim apo qëndrim publik të ASH-së, për të formalizuar një detyrim të ligjit apo për të ratifikuar një marrëveshje kuadër, për shpalljen e vendeve të lira, ose për pjesëmarrje në një aktivitet apo forum për çështje të ndjeshme.
2. Çështja për të cilën kërkohet marrja e një vendimi qarkullues, formulohet e propozohet nga Kryesia. Ajo u përcillet anëtarëve elektronikisht dhe quhet e pranuar, kur janë shprehur mbi 2/3 e tyre dhe ka fituar shumicën e të shprehurve. Pas mbylljes së afatit të votimit, vendimi

quhet i pranuar edhe n.q.s. kanë votuar "pro" mbi 1/3 e anëtarëve të Asamblesë gjithsej, pavarësisht nga pjesëmarrja në votim.

3. Kur 1/3 e anëtarëve vlerësojnë se çështja duhet të bëhet pjesë e debatit në Asamble, atëherë ajo i kalon mbledhjes më të afërt të Asamblesë.

Neni 27

Thirrja e mbledhjeve të Asamblesë

1. Mbledhjet e Asamblesë thirren nga Kryesia dhe drejtohen nga Kryetari.
2. Njoftimi për mbledhje bëhet 30 ditë përpara me një rend dite paraprak.
3. Mbledhjet thirren me një rend dite të plotë, që u bëhet e ditur anëtarëve, 15 ditë para.
4. Çdo anëtar i Asamblesë mund t'i kërkojë Kryesisë, përfshirjen e një çështjeje në rend të ditës (që nuk rregullohet posaçërisht në këtë statut), e cila, brenda 7 ditësh e njofton për pranimin ose jo. Kur kjo kërkohet nga 7 anëtarë të Asamblesë, atëherë Kryesia ia paraqet kërkesën Asamblesë, e cila me hapjen e mbledhjes shprehet paraprakisht për përfshirje ose jo në rendin e ditës.

Neni 28

Mbledhjet vjetore

1. Mbledhja vjetore e Asamblesë është mbledhja që, si rregull, zhvillohet në fund të vitit në të cilën miratohet projektbuxheti dhe programi vjetor i ASH-së. Kjo mbledhje bëhet e zgjeruar, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Kuvendit, Këshillit të Ministrave, Ministrisë që mbulon shkencën, institucioneve të arsimit të lartë e qendrave kryesore të kërkimit në vend.
2. Përfaqësuesit e institucioneve kanë të drejtë të marrin pjesë në debat e të bëjnë sugjerime apo propozime.
3. Në këtë mbledhje mundësohet pjesëmarrja sa më e madhe e anëtarëve të jashtëm e të nderit.

Neni 29

Mbledhjet e posaçme

1. Mbledhjet e posaçme thirren nga Kryesia për çështje të veçanta, që përligjin thirrjen e Asamblesë për nga rëndësia dhe koha.
2. Procedurat e thirrjes së saj janë si ato të parashikuara në nenin 27, pikat 1, 2, 3, të Statutit, por afatet janë: 10 ditë para, për thirrjen e mbledhjes; 5 ditë para për përcaktimin e rendit të ditës.

Neni 30

Detyrat e Kryesisë

1. Organizon e drejton Akademinë, në bazë e në zbatim të ligjit, statutit e vendimeve të Asamblesë;
2. Ndjek dhe organizon punën e seksioneve, komisioneve, si dhe të njërive të ngritura pranë Akademisë;
3. Organizon e drejton punën e administratës së Akademisë, përfshirë edhe entin botues, në bazë të "Rregullores së brendshme";
4. Përgatit projektprogramin e projektbuxhetin;
5. Përgatit mbledhjet e Asamblesë;
6. Përgatit raportin vjetor;
7. Për kryerjen e detyrave të saj Kryesia nxjerr vendime të brendshme;
8. Kryesia drejtohet nga Kryetari i Akademisë.

Neni 31

Detyrat e Kryetarit

1. Drejton e organizon punën dhe veprimtarinë e Akademisë e të Kryesisë;
2. Përfaqëson Akademinë në marrëdhënie me të tretët dhe nënshkruan në emër të saj;
3. Raporton në Asamble për aktivitetin e përgjithshëm, e në Kryesi për aktivitetin gjashtëmujor;
4. Drejton mbledhjet e Asamblesë;
5. Nënshkruan vendimet e Kryesisë e të Asamblesë;
6. Zbaton detyrat e përcaktuara në Statut;
7. Në zbatimin e detyrave e kompetencave të tij, Kryetari nxjerr urdhra;
8. Detyrat e Kryetarit, në mungesë të tij (e me porosi), i kryen Zëvendëskryetari.

Neni 32

Mbledhjet e Kryesisë

1. Kryesia e ASH-së, si rregull, mbledhet një herë në javë.
2. Kryesia thirret nga Kryetari me ose pa rend dite.
3. Mbledhjet e rregullta lajmërohen të paktën 48 orë para, shoqëruar me rendin e ditës dhe projektet për të cilat kërkohet të merret vendim.
4. Vendimet Kryesia i merr me shumicën e thjeshtë, në rast barazimi vendos vota e Kryetarit.
5. Kryesia zhvillon edhe mbledhje periodike, me qëllim këshillimor e informues për ecurinë e punës në zbatim të detyrave të saj.
6. Çdo komision e seksion ka të drejtën t'i propozojë Kryesisë shqyrtimin e marrjen e një vendimi të caktuar, bazuar në programin vjetor dhe në nenet 4 e 6 të këtij Statuti.

V

STRUKTURAT ORGANIZATIVE DHE NJËSITË NDIHMËSE

Neni 33 Seksionet

Me qëllim organizimin e punës dhe realizimin më të mirë të funksioneve të saj, anëtarët e Asamblesë rigrupohen në seksione sipas grup-fushave kryesore.

Neni 34 Organizimi i seksioneve

Akademia e Shkencave ka në përbërje të saj këto seksione:

- Seksioni i Shkencave Shoqërore Albanologjike
- Seksioni i Shkencave Natyrore - Teknike

Hapja ose mbyllja e një seksioni bëhet vetëm me propozim të Kryesisë e me vendim të Asamblesë.

Neni 35 Detyrat e Seksionit

Seksioni ka këto detyra kryesore:

1. Të organizojë e bashkërendojë zbatimin e detyrave dhe aktiviteteve të vendosura nga Asambleja dhe Kryesia.
2. Të ndjekë zhvillimin e shkencës dhe të kërkimit shkencor në fushat përkatëse me qëllim promovimin e tyre, nëpërmjet organizimit të konferencave, kongreseve e seminareve shkencore me karakter kombëtar e ndërkombëtar.
3. Të propozojë ngritjen e njësive të kërkim-studimit apo të komisioneve të posaçme për shqyrtimin e çështjeve të rëndësishme në fushat e tyre.
4. Të botojë revista shkencore të specializuara, të caktojë kriteret themelore për botimet e ASH-së dhe ndarjen e kuotave të këtyre botimeve.
5. Të bëjë propozime për botimin e veprave akademike në fushat përkatëse, apo për veprat e akademikëve më në zë.
6. Të zbatojë detyrat dhe kompetencat e dhëna nga ky statut.

Neni 36

Përbërja e seksioneve

1. Çdo seksion përbëhet nga anëtarët e Asamblesë, të cilët u përkasin fushave përkatëse.
2. Çdo 4 vjet (në çdo vit zgjedhor), çdo anëtar i Asamblesë shpreh vetë interesin për pjesëmarrje në një seksion. Kryesia përgatit listat sipas përkatësive e pëlqimeve dhe ato miratohen nga Asambleja.
3. Gjatë kësaj periudhe, për anëtarësimet e reja apo për zëvendësimin e anëtarëve të larguar, përcaktimi i pjesëmarrjes në një seksion bëhet me propozim të seksionit përkatës dhe me miratimin e Kryesisë.
4. Çdo seksion drejtohet nga Kryetari i Seksionit dhe ka në përbërje edhe sekretarin teknik. Kryetari i Seksionit zgjidhet sipas këtij statuti. Sekretari teknik emërohet nga Kryesia me propozim të Kryetarit të Seksionit.

Neni 37

Mbledhjet e seksionit

1. Seksioni mbledhet të paktën 4 herë në vit. Mbledhjen e Seksionit e thërret Kryetari, në bazë të një rendi dite, i cili bëhet i njohur të paktën 7 ditë para.
2. Kryetari i ASH-së, Kryesia apo çdo 5 (pesë) anëtarë të Seksionit mund të kërkojnë mbledhjen e tij për një çështje të caktuar, ose përfshirjen e një çështjeje - në rend të ditës, në mbledhjen e radhës.
3. Mbledhjet e Seksionit bëhen kur në të merr pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm. Votimi, si rregull, bëhet i hapur, përveçse kur votohet për pranimet e reja.
4. Në mbledhjen e seksionit marrin pjesë edhe të ftuar specialistë apo ekspertë të fushave përkatëse.

Neni 38

Komisionet

Komisionet e përhershme ngrihen pranë ASH-së, me anëtarë të së njëjtës fushë ose të fushave të përafërta, me qëllim mundësimin e një komunikimi e një debati më të specializuar.

Neni 39

Ngritja e komisioneve

Komisionet e ngritura sipas këtij Statuti janë në listën bashkëngjitur **(aneksi 4)***

Neni 40

Detyrat e Komisionit

Komisionet kanë për detyrë:

- 1) Të bashkëpunojnë me seksionet në realizimin e aktiviteteve të programuara nga ASH.
- 2) Të ndjekin posaçërisht zhvillimet në shkencë e kërkim shkencor brenda dhe jashtë vendit, në fushën përkatëse, me qëllim dhënien e mendimeve dhe paraqitjen e propozimeve sa më të argumentuara, për përcaktimin e drejtë të zhvillimit, evidentimin e problematikave, ngritjen e njërive të kërkim-studimit apo komisioneve të posaçme.
- 3) Të hartojnë raporte, opionenca apo ekspertiza të kërkuara pranë Kryesisë apo Seksionit.
- 4) Të propozojë organizimin e aktiviteteve shkencore, për botime të caktuara apo për vlerësim ndihmesash studimore.
- 5) Të mbajnë lidhje me institucionet ndërkombëtare më aktive në fushat përkatëse e me njësitë kryesore të kërkimit në vend.
- 6) Të kryejnë detyrat e vëna nga ky Statut, nga Seksioni apo nga Kryesia.

Neni 41**

Përbërja e komisioneve

1. Komisionet përbëhen nga anëtarët e Asamblesë të fushave përkatëse dhe, si rregull, nga 5-10 anëtarë të jashtëm, përfaqësues të Akademisë së të Rinjve, të institucioneve të arsimit të lartë dhe të qendrave kryesore të kërkimit, ndër personat më të kualifikuar sipas fushave.
2. Anëtarët e jashtëm përcaktohen nga Kryesia, në bazë të propozimeve të Akademisë së të Rinjve, për përfaqësuesit e tyre, dhe në bazë të personave që kanë shprehur interes dhe të atyre të propozuar prej anëtarëve të Asamblesë, pjesëtarë të Komisionit përkatës, për përfaqësuesit e institucioneve të tjera.
3. Përbërja përfundimtare shpallet nga Kryesia.

Neni 42

Mbledhjet e Komisionit

1. Komisionet mbledhen si rregull një herë në dy muaj.

*Ndryshuar me vendimin e Asamblesë nr. 1, dt. 9.01.2024

* *Ndryshuar me vendimin e Asamblesë nr.17, dt.21.02.2020.

2. Komisioni drejtohet nga një kryetar, i zgjedhur si rregull ndër anëtarët, anëtar Asambleje. Kryetarët e komisioneve caktohen nga Kryesia. Sekretari teknik i Seksionit luan rolin e sekretarit teknik të komisioneve përkatëse.
3. Mbledhjet janë të rregullta, kur thirren me një rend dite, lajmërohen 3 (tri) ditë para dhe në to marrin pjesë mbi gjysma e anëtarëve. Vendimet merren me shumicën e të pranishmëve.

Neni 43

Njësitë e kërkim-studimit

Njësitë e kërkim-studimit janë instrumentet e organet më të specializuara, që ngrihen pranë ASH-së, në bazë të ligjit të saj, për të realizuar një detyrë të rëndësishme studimore apo kërkimore, që i kërkohet ASH-së, apo që ajo ia shtron vetes, në zbatim të rolit të saj të parashikuar në nenin 4, të ligjit nr.53/2019 e të këtij Statuti.

Neni 44

Njësitë afatshkurtra

1. Për të studiuar ose për të hulumtuar në një drejtim të caktuar me qëllim: aplikimin për projekte të rëndësishme a realizimin e drejtimin e tyre; hartimin e një raporti për të propozuar ngritjen e një njësie në rang instituti pranë ASH-së a gjetkë; përcaktimin e përparësive kryesore të kërkimit, pasqyrimin të problemeve e arritjeve në një fushë apo në tërësi në kërkimin shkencor; efektivitetin e një ndërmarrjeje të rëndësishme në kërkimin shkencor apo në ekonomi, vlerësimin e shkallës së pasqyrimin të shkencës në formimin e brezave dhe specialistëve të rinj, ASH ngre njësi studim-kërkimi me afat deri 2-vjeçar.
2. Njësitë ngrihen me vendim të Kryesisë, pas konfirmimit nga Asambleja ose seksioni përkatës. Vendimi i ngritjes së tyre përcakton qartë qëllimin, detyrat që ka njësia, kohën e aktivitetit, aktin përfundimtar që duhet të nxjerrë, si dhe kujt do t'i drejtohet ky akt për rekomandim apo zbatim. Vendimi përmban edhe mbështetjen financiare e logjistike të njësisë dhe vendin e ushtrimit të aktivitetit.
3. Njësia drejtohet, si rregull, nga një anëtar i Asamblesë e përbëhet nga anëtarë të Asamblesë, specialistë dhe punonjës ndihmës.
4. Veprimet financiare kryhen nga administrata e Akademisë së Shkencave, nën drejtimin dhe përgjegjësinë e Kancelarit.

Neni 45

Njësitë afatgjata të kërkim-studimit

1. Pranë ASH-së për nxitjen e mbështetjen e drejtpërdrejtë të zhvillimit të kërkimit shkencor e të mendimit të specializuar në fusha me rëndësi të veçantë: për historinë, gjuhën, kulturën e vendit, për sektorët kryesorë të ekonomisë, si dhe për sfidat e zhvillimit të së ardhmes, që duan një interes të veçantë, ngrihen ose atashohen njësi afatgjata të kërkim-studimit, në nivel institutesh.
2. Këto njësi ngrihen me vendim të Asamblesë, me propozim të seksionit përkatës e të Kryesisë. Në projektvendim përcaktohen: qëllimi, fushat e kërkimit, organika, mbështetja financiare, organet drejtuese, marrëdhëniet me ASH-në. Praktika i përcillet Këshillit të Ministrave.
3. Njësitë afatgjata kanë buxhetin e tyre, si zë më vete, në buxhetin e ASH-së.
4. Veprimet financiare kryhen nga aparati i ASH-së, në bazë të planifikimit e urdhërimeve të vetë njësisë.
5. Njësia raporton për aktivitetin e saj pranë Asamblesë në mbledhjen e saj vjetore. ASH harton një raport vlerësimi për punën e institutit në të cilin jepen edhe rekomandime për të ardhmen.
6. Pranë ASH-së ngrihet bordi i drejtorëve të njësive afatgjata të kërkim-studimit. Mbledhjen mujore të të cilit e drejton Kryetari i ASH-së. Drejtuesi i Njesisë informon rregullisht Kryesinë dhe Kryetarin e ASH-së.

Neni 46

Akademia e të Rinjve

1. Me qëllim që të nxitet drejtpërdrejt veprimtaria kërkimore-shkencore e kërkuesve të rinj, si dhe për vendosjen e një ure komunikimi dhe promovimi me ta, funksionon Akademia e të Rinjve, si organ këshillues e bashkëpunues pranë Akademisë. Akademia e të Rinjve ka deri në 20 anëtarë, të zgjedhur nga radhët e kërkuesve të rinj me gradën shkencore “doktor”. Mandati si anëtar është 4 vjet, përjashtimisht deri në 7 vjet dhe ndërpritet në moshën 40 vjeç.
2. Në përbërjen e saj synohet përfaqësimi nga të gjitha fushat kryesore të dijes, kulturës e shkencës.
3. Anëtarët e Akademisë së të Rinjve përfshihen në komisionet e Akademisë, marrin pjesë në mbledhjet e seksioneve, si dhe një përfaqësi prej 3-4 personash nga radhët e tyre marrin pjesë në mbledhjen vjetore të Asamblesë, ku miratohet raporti, plani vjetor e projektbuxheti i Akademisë së Shkencave.

4. Akademia e të Rinjve funksionon si një organizëm autonom, në bazë të statutit të miratuar prej saj dhe me vendim të Kryesisë.

VI INSTITUTET DHE QENDRAT KËRKIMORE TË PËRHERSHME¹

Neni 47 Ngritja e instituteve dhe qendrave kërkimore

Institutet dhe qendrat kërkimore të përhershme janë *njësi kërkimore-studimore me status të veçantë*, që ngrihen sipas nenit 19 të Ligjit nr. 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë*;

Riorganizimi ose mbyllja e njësive të përhershme të kërkim studimit bëhet me vendim të Asamblesë së Akademisë së Shkencave sipas procedurave të parashikuara në këtë Statut.

Hapja, riorganizimi ose mbyllja e njësive bazë (departament dhe/ose sektor) të njësive të përhershme të kërkim studimit bëhet me vendim të Kryesisë, sipas procedurave të parashikuara në këtë Statut.

Ato janë organet më të rëndësishme kërkimore-shkencore *të linjës së parë* në shkallë vendi, që funksionojnë pranë Akademisë së Shkencave (më tej: ASHSH) dhe e zhvillojnë veprimtarinë e tyre konform parimeve bazë në veprimtarinë shkencore, kodit evropian të etikës në kërkimin shkencor, Ligjit nr. 53/2019 dhe këtij Statuti.

Objekti i veprimtarisë së tyre është zhvillimi i veprimtarisë kërkimore-studimore dhe transmetimi i dijes në një fushë a grup fushash të përafërta të shkencës, sipas përcaktimit në aktin e themelimit, me qëllim ideimin e hartimin e strategjive të kërkimit shkencor në nivel kombëtar; koordinimin e tij me institucionet e tjera; nxitjen, promovimin e realizmin e kërkimit shkencor nëpërmjet projekteve madhore e/a që kërkojnë ekspertizën më të lartë shkencore.

Institutet e qendrat kërkimore luajnë rol aktiv, si institucion a nëpërmjet angazhimit të punonjësve të tyre kërkimorë: në transmetimin e dijeve shkencore në fushën/at përkatëse; në formimin e kërkuesve dhe specialistëve të lartë të rinj; veçanërisht me anë të pjesëmarrjes në hartimin e kurrikulave e të organizimit të programeve të ciklit të dytë e të tretë të formimit (pas)universitar.

Pranë Akademisë së Shkencave funksionojnë qendrat e përhershme sipas aneksit 5.

¹ Shtuar me vendimin e Asamblesë nr. 1, datë 9.01.2024.

Neni 48

Organizimi e struktura

Institutet përbëhen nga organet drejtuese, departamentet/seksionet dhe drejtuesit e tyre; ndërsa qendrat, si rregull, organizohen në seksione.

Organet kryesore drejtuese të institutit janë drejtori dhe këshilli shkencor, ndërsa akte rregulluese të funksionimit të tij janë ky Statut dhe rregulloret e brendshme të përgjithshme a të veçanta. Qendrat, në vend të këshillit shkencor, mund të kenë një bord për shkencën, sipas përcaktimeve në këtë Statut.

Neni 49

Këshilli shkencor

Këshilli shkencor i institutit është organi më i lartë vendimmarrës për drejtimin dhe vlerësimin e veprimtarisë shkencore të tij. Këshilli shkencor përbëhet nga 7-11 anëtarë, me një mandat 4-vjeçar; ndërsa bordet kanë 5-7 anëtarë, me të njëjtin mandat.

Neni 50

Detyrat e kompetencat e këshillit

Këshilli shkencor i institutit ka këto kompetenca kryesore:

- Miraton programin vjetor e atë afatmesëm të institutit në përputhje me ato të institucionit.
- Përcakton politikat e planin strategjik të tij në përputhje me misionin e strategjinë e institucionit.
- Vlerëson nga ana shkencore veprimtarinë e punonjësve kërkimorë-shkencorë e shprehet për botimin e tyre.
- Jep mendim për projektbuxhetin dhe njihet me detajimin e tij, pas miratimit sipas VKM nr. 821, datë 28.12.2023 *Për ngritjen dhe organizimin e njësive të përhershme të kërkim-studimit në albanologji pranë Akademisë së Shkencave në Republikën e Shqipërisë*. Në rast mospajtimi me propozimin e drejtorit, këshilli i drejtohet bordit të drejtorëve e kur mospajtimi është midis instituteve i drejtohet Kryesisë së ASHSH, nëpërmjet drejtorit.
- Jep pëlqimin paraprak a propozon ndryshime në rregulloret e brendshme të institucionit dhe në këtë Statut, për pjesën që lidhet me institutet.
- Miraton rregulloren e tij të brendshme në përputhje e zbatim të rregullores së përgjithshme.
- Ndjek veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe miraton raportin e veprimtarisë vjetore të institutit.
- Shqyrton dhe propozon/miraton marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet analoge kombëtare dhe ndërkombëtare, në përputhje me fushën e tij të veprimtarisë.

- Ndjek respektimin e kodit të etikës në institut dhe për personelin e tij, si dhe propozon masa organizative e disiplinore gjegjësisht për zbatimin / shkeljen e tij.
- Nxiti dhe mbështet zhvillimin e karrierës profesionale të punonjësve kërkimorë-shkencorë.
- Propozon kriteret profesionale për rekrutimin e kategorizimin e tyre.
- Propozon a jep mendimin për riorganizimin e institutit apo të departamenteve të tij.
- Bashkëpunon me drejtorin për kryerjen e funksioneve të tij.

Neni 51

Përbërja dhe zgjedhja e këshillit

Këshilli shkencor i institutit përbëhet nga kërkues nga më të njohurit të fushës përkatëse: pjesë e personelit kërkimor të institutit; anëtarë të Akademisë së Shkencave; punonjës me tituj akademikë të IAL-ve a nga diaspora. Një e treta e anëtarëve të tij përzgjidhet nga komisioni i përhershëm i fushës pranë ASHSH dhe një deri dy anëtarë - prej IAL-ve.

Numri i anëtarëve të këshillit në asnjë rast nuk mund të jetë më shumë se gjysma e personelit kërkimor. Kur instituti nuk e plotëson dot këtë kusht, zgjidhet një këshill i përbashkët me një institut a qendër tjetër të afërt. Numri i përgjithshëm i anëtarëve dhe struktura e përbërjes së këshillit për institutin përcaktohen nga bordi i drejtorëve, me propozim të drejtorit të institutit.

Anëtarët nga kërkuesit e institutit zgjidhen nga punonjësit kërkimorë brenda tij me votim të drejtpërdrejtë e të fshehtë, ndërsa anëtarët e tjerë zgjidhen nga Kryesia e ASHSH, me propozim të komisionit përkatës, mbështetur në të dhënat e dosjeve vetjake të kandidatëve. Kriteret për zgjedhjen e tyre përcaktohen me një akt të bordit të drejtorëve.

Neni 52

Drejtori

Drejtuuesi i institutit / qendrës zgjidhet / emërohet sipas përcaktimeve në këtë Statut, përveç rastit kur kjo është parashikuar ndryshe në aktin e krijimit (për qendrat).

Drejtuuesi i institutit / qendrës duhet të ketë të paktën kategorinë *Mjeshtër kërkimesh*. Ai zgjidhet / emërohet për një mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhje ose riemërimi vetëm një herë.

Drejtuuesi i institutit është përfaqësuesi ligjor i tij dhe drejton këshillin shkencor.

Neni 53

Funksionet dhe kompetencat e drejtorit

Funksionet dhe kompetencat e drejtorit të institutit / qendrës janë:

- Ndjek, organizon e drejton veprimtarinë e përgjithshme të institutit.
- Drejton Këshillin Shkencor të institutit.

- Bën detajimin e buxhetit vjetor të caktuar për institutin / qendrën përkatëse dhe, pas paraqitjes në bordin e drejtorëve, ndjek e përgjigjet për zbatimin e tij.
- Organizon punën për zbatimin e programit vjetor nga institucioni e çdo punonjës i tij.
- Vlerëson punën vjetore të punonjësve kërkimorë-shkencorë sipas rregullores përkatëse.
- Informon në vazhdimësi drejtpërdrejt Kryesinë e Kryetarin e ASHSH mbi veprimtarinë e institutit / qendrës.
- Merr pjesë në mbledhjet e bordit të drejtorëve, ku shtron e informon për ecurinë e punës e për probleme të dala gjatë saj, si dhe merr masa për zbatimin e detyrave a vendimeve që merren nga ky bord.
- Merr masat disiplinore për vartësit për shkelje të disiplinës në punë, etikës etj., sipas parashikimeve në rregulloren e brendshme.
- Propozon, me pëlqimin e këshillit, ndryshime strukturore a organizative për institucionin;
- Nënshkruan në emër të institucionit protokollet e bashkëpunimit dhe marrëveshjet, sipas përcaktimit në neneve 50 e 66 të këtij Statuti.

Neni 54 **Zgjedhja e drejtorit**

Zgjedhja e drejtorëve të instituteve bëhet me votim të drejtpërdrejtë e të fshehtë nga trupa zgjedhore e përbërë nga punonjësit kërkimorë-shkencorë e anëtarët e komisionit të përhershëm përkatës.

Procedura me të hollësishme përcaktohen me nënakt të veçantë.

Kandidati i zgjedhur emërohet nga Kryesia e ASHSH.

Për qendrat, si rregull, drejtuesi zgjidhet nga Kryesia e ASHSH, me propozim të bordit shkencor të qendrës. Për rastin kur qendra ka këshill shkencor të përbashkët me një institut/qendër tjetër, zgjedhja bëhet si për drejtuesit e instituteve.

Neni 55 **Departamenti/seksioni**

Departamenti është njësia bazë përbërëse e institutit. Një institut ka të paktën dy departamente.

Departamenti përbëhet nga punonjës kërkimorë të një disipline, tematike a periudhe, apo të disa disiplinave të përafërta të kërkimit.

Departamenti kryen këto funksione kryesore:

- ndjek, organizon e vlerëson veprimtarinë shkencore të punonjësve të tij e të bashkëpunëtorëve, në përputhje me programin vjetor të institutit;

- diskuton e miraton veprat e punimet shkencore të përgatitura prej anëtarëve e bashkëpunëtorëve dhe ia përcjell për miratim këshillit shkencor të institutit;
- propozon kriteret që duhen plotësuar për vendet e punonjësve shkencorë të departamentit;
- harton dhe propozon raportin vjetor për veprimtarinë e departamentit dhe nevojat e tij buxhetore;
- jep mendim apo propozon për ndryshime strukturore, që prekin departamentin;
- kryen çdo funksion që i jepet nga ky Statut e rregulloret përkatëse.

Të njëjtat funksione kryen edhe seksioni.

Kritere specifike për ngritjen e departamenteve dhe seksioneve përcaktohen me nënakt të bordit të drejtorëve.

Neni 56 **Drejtuesi i departamentit/seksionit**

Drejtuesi i departamentit / seksionit është drejtuesi i veprimtarisë shkencore dhe përfaqësuesi i tij.

Drejtuesi i departamentit / seksionit zgjidhet nga radhët e kërkuesve me titull shkencor së paku *Mjeshtër kërkimesh* ose me gradën shkencore PhD të mbrojtur në një vend anëtar të BE-së ose OECD-së. Në mungesë të kandidatëve që i plotësojnë këto kushte mund të zgjidhet edhe një kërkues me gradën *doktor i shkencave*. Ata kandidohen nga një grup kërkuesish ose vetëkandidohen. Drejtuesi i njësisë bazë emërohet nga drejtori për një mandat 4-vjeçar.

Drejtuesi i departamentit/seksionit kryen këto detyra:

- Ndjek dhe koordinon hartimin, miratimin e zbatimin e planit vjetor të veprimtarisë shkencore të departamentit/seksionit dhe të punonjësve të tij;
- Mban lidhjet me departamentet/seksionet e tjera të institutit/qendrës dhe organizon veprimtaritë e përbashkëta të tyre;
- Jep pëlqimin për pjesëmarrjen e anëtarëve të tij në projekte / programe me karakter institucional e ndërinstitutional;
- Propozon vlerësime pune e masa disiplinore për punonjësit e vet.

Neni 57 **Bashkëpunimi i instituteve dhe qendrave**

Institutet e qendrat e kërkimit shkencor bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, si dhe me institucione të tjera, publike a jopublike, vendëse ose të huaja, sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura

drejtpërdrejt apo në kuadër të marrëveshjeve të ASHSH me institucione respektive, me qëllim realizimin e misionit të tyre në fushën e kërkimit shkencor.

Bashkëpunimi me IAL-të bëhet kryesisht me qëllim:

- zhvillimin e programeve të studimit të ciklit të dytë dhe të tretë të formimit (pas)universitar, nëpërmjet vënies në dispozicion të logistikës, infrastrukturës dhe burimeve njerëzore;
- zhvillimin e projekteve të përbashkëta të kërkimit shkencor;
- shkëmbimin e informacionit, të dijeve, të inovacioneve dhe të produkteve të kërkimit.

Neni 58

Personeli i instituteve e qendrave kërkimore-shkencore

Personeli i instituteve dhe i qendrave të kërkimit shkencor pranë ASHSH përbëhet nga punonjësit kërkimorë-shkencorë e nga punonjësit ndihmës tekniko-shkencorë e ata administrativë.

Punonjësit kërkimorë-shkencorë gëzojnë statusin e personelit akademik në IAL-të publike të kategorisë *universitet*; ata rekrutohen nëpërmjet një konkurrimi publik, bazuar në procedurat dhe kriteret e përcaktuara në një nënakt të veçantë të miratuar nga bordi i drejtorëve.

Punonjësit ndihmës tekniko-shkencor janë punonjësit që kanë kualifikim profesional të duhur për të kontribuar në veprimtarinë shkencore, nën drejtimin e punonjësve kërkimor-shkencor, në përputhje me përshkrimin e vendit të punës.

Në personelin administrativ përfshihen punonjësit që ushtrojnë detyra administrative në mbështetje të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njesisë, në përputhje me përshkrimin e vendit të punës.

Rekrutimi i personelit ndihmës tekniko-shkencor dhe atij administrativ bëhet sipas rregullore së përgjithshme të administratës të ASHSH.

Institutet e qendrat e kërkimit shkencor kanë të drejtë të punësojnë për periudha të shkurtra kohe kërkues e studiues, personalitete në fushën e kërkimit shkencor, vendës ose të huaj. Personeli i ftuar punësohet e shpërblehet sipas përcaktimeve në aktin e kontraktimit.

Neni 59

Të drejtat dhe detyrat e punonjësit kërkimorë-shkencorë

Punonjësi kërkimor-shkencor ka të drejtë:

- të zgjedhë lirisht drejtimin e metodën e kërkimit shkencor sipas synimeve të tij shkencore, si dhe në funksion dhe në përputhje me veprimtarinë e misionin e institucionit pranë të cilit është i punësuar;

- të marrë pjesë në formimin e kërkuesve dhe specialistëve të lartë për fushën përkatëse, nëpërmjet aktivitetit të mësimdhënies në të gjitha ciklet e studimit, si dhe udhëheqjes së diplomave të ciklit të dytë dhe tretë, në përputhje me kriteret e akteve nënligjore përkatëse;
- të ketë mbështetjen e nevojshme financiare për realizimin e planit të punës kërkimore-shkencore dhe promovimin në karrierë;
- të ketë kushtet e duhura logjistike dhe të punës në shërbim të kryerjes së veprimtarisë së tij kërkimore-shkencore;
- të marrë pjesë në kurse kualifikimi, shkëmbim përvoja, ose veprimtari kërkimore-shkencore pranë institucioneve analoge dhe të tjera të afërta, brenda ose jashtë vendit;
- të vlerësohet dhe shpërblehet për punën e tij në bazë të cilësisë dhe rëndësisë së rezultateve, si dhe për punën shtesë në kuadër të pjesëmarrjes në veprimtari të kërkimit shkencor; masa dhe mënyra e shpërblimit përcaktohen me akte nënligjore;
- të publikojë rezultatet e punës së tij kërkimore;
- të gëzojë të drejtat e tij intelektuale të rezultateve dhe botimeve të tij, sipas legjislacionit përkatës e parashikimeve kontraktore me institucionin ku është punësuar.

Punonjësi kërkimor-shkencor ka detyrimin:

- të plotësojë detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës dhe parashikimet në nënaktet e këtij Statuti;
- të zbatojë këtë Statut e rregulloren e institucionit kërkimor-shkencor;
- të respektojë kodin e etikës dhe rregulloren e përgjithshme për disiplinën në punë;
- të zbatojë programin e veprimtarisë kërkimore-shkencore;
- të respektojë parimet e shkencës së hapur;
- të ndjekë programet e detyrueshme të kualifikimit, të përcaktuara me aktet e brendshme të institucionit të kërkimit shkencor;
- të mbrojë dhe ruajë interesat e ligjshme të institucionit e njësisë; të dhënat, informacionet e sekretet profesionale;
- të paraqesë relacion me shkrim për veprimtarinë vjetore në fund të vitit a kur i kërkohet nga drejtuesit.

Të drejtat dhe detyrimet të tjera të personelit përcaktohen në Statut dhe në aktet përkatëse të institucionit, në përputhje me ligjet në fuqi.

Neni 60

Kategoritë e punonjësve kërkimorë-shkencorë

Punonjësit kërkimorë-shkencorë në institute/qendra klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- asistent kërkues shkencor;

- kërkues shkencor;
- mjeshtër kërkimesh;
- drejtues kërkimesh.

Secila prej kategorive të përshkruara si më sipër në këtë nen fitohet mbështetur në kriteret e mëposhtme:

Kategorinë *asistent kërkues shkencor* e fiton çdo punonjës i institucionit të kërkimit shkencor në momentin e emërimit me kohë të plotë. Punonjësit e kësaj kategorie duhet të kenë së paku diplomën *master i shkencave*.

Kategorinë *kërkues shkencor* e fiton çdo punonjës kërkimor-shkencor i kategorisë *asistent kërkues shkencor*, i cili ka mbrojtur gradën *doktor i shkencave*; kandidati që e ka mbrojtur para emërimit gradën *doktor i shkencave* e fiton këtë kategori menjëherë.

Kategorinë *Mjeshtër kërkimesh* e fiton çdo punonjës kërkimor-shkencor i kategorisë *kërkues shkencor*, që kryen veprimtari kërkimore-shkencore për së paku 5 (pesë) vjet në këtë kategori, me rezultate të matshme, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e institucionit. Në rastin kur personi mban titullin *profesor i asociuar* a ka fituar gradën *doktor i shkencave* në një nga vendet e BE-së ose OECD-së, kjo kategori i jepet drejtpërsëdrejti pas emërimit si punonjës kërkimor-shkencor.

Kategorinë *Drejtuës kërkimesh* e fiton çdo punonjës kërkimor-shkencor i kategorisë *Mjeshtër kërkimesh*, që kryen veprimtari kërkimore-shkencore brenda a jashtë vendit për së paku 5 (pesë) vjet pas fitimit të kësaj kategorie, me rezultate të matshme, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e institucionit. Në rastin kur kandidati mban titullin akademik *profesor*, kjo kategori i jepet drejtpërsëdrejti pas emërimit.

Neni 61 Titujt *Emeritus*

Institucionet e kërkimit shkencor u akordojnë titullin *Drejtuës emeritus* punonjësve të kategorisë *Drejtuës kërkimesh* pas daljes në pension, në vlerësim të veprimtarisë së spikatur kërkimore-shkencore të tyre, sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli Kombëtar i Shkencës (KKSH).

Drejtuësi emeritus mund të vazhdojë veprimtarinë me kohë të plotë edhe për dy vjet, sipas nevojave të institucionit kërkimor-shkencor.

Për merita të veçanta, me ndikim në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare në tërë veprimtarinë akademike, institucioni mund t'i propozojë ASHSH e nëpërmjet saj KKSH dhënien e titullit të lartë *Shkencëtar emeritus*. Procedura e akordimit të titullit *Shkencëtar emeritus* dhe të drejtat që lidhen me këtë titull përcaktohen në rregulloren e institucionit kërkimor-shkencor.

Neni 62
Lëvizshmëria e punonjësit kërkimor-shkencor

Punonjësit kërkimorë-shkencorë mund të ushtrojnë veprimtari kërkimore-shkencore pranë një institucioni analog jashtë vendit, për një periudhë kohore të caktuar, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, sipas nenit 59, pika 5 në kuadër të një projekti apo marrëveshjeje bashkëpunimi. Rregullat, kriteret dhe kohëzgjatja e periudhës së qëndrimit; marrëdhëniet administrative e ato financiare dhe raportet e punonjësit me institucionin kërkimor, përcaktohen sipas rregullores e/a marrëveshjes midis palëve.

Pranë një institucioni kërkimor-shkencor të ASHSH mund të ushtrojnë veprimtari kërkimore-shkencore kërkues të huaj, në kuadër të një projekti a marrëveshjeje bashkëpunimi, për një periudhë të caktuar kohe, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe aktet e brendshme të tij.

Neni 63
Viti akademik sabatik

Punonjësi kërkimor-shkencor ka të drejtë të shkëputet nga angazhimet e institucionit për t'u kujdesur për përparimin e vet profesional një herë në 7 (shtatë) vjet, për periudhë kohe deri në 1 (një) vit.

Miratimi i periudhës sabatike bëhet nga titullari i institucionit; të drejtat dhe detyrimet e përfituesit të periudhës sabatike përcaktohen në Statut dhe në rregulloret e brendshme.

Neni 64
Vlerësimi i punës së punonjësit kërkimor-shkencor

Rezultatet e punës së punonjësit kërkimor-shkencor vlerësohen në vazhdimësi në mënyrë periodike në institucionin ku ushtron aktivitetin, prej strukturave të ngritura për këtë qëllim.

Neni 65
Bordi i drejtorëve të instituteve dhe njësive kërkimore-shkencore

Bordi i drejtorëve është organi kryesor për koordinimin e harmonizimin e veprimtarisë së instituteve në zbatim të programit e të strategjisë së kërkimit shkencor të ASHSH dhe të instituteve të rrjetit të saj; veçanërisht për menaxhimin e buxhetit.

Bordi ngrihet e funksionon në bazë të nenit 45 të këtij Statuti dhe përbëhet nga drejtuesit e instituteve, të qendrave të përhershme dhe të njësive të përkohshme, me afat dyvjeçar; si dhe nga kryetarët e komisioneve të përhershme gjegjëse të ASHSH.

Kryetari i ASHSH drejton bordin e drejtorëve, i cili mblidhet të paktën një herë në dy muaj.

Mbledhjet thirren me rend dite që njoftohet të paktën tri ditë para kur kërkohet të miratohen apo të jepet pëlqim për projekte, propozime, akte njësuese, raporte etj.

Bordi mblidhet jashtë radhe për çështje informimi e organizimi të punës a trajtim këshillues të problemeve të ngritura nga një institut, njësi a komision dhe nga Kryesia e ASHSH.

Neni 66

Funksionet e bordit të drejtorëve

Bordi i drejtorëve ka këto funksione e detyra:

- garanton respektimin e autonomisë dhe lirisë akademike në veprimtarinë kërkimore-shkencore e atë financiare të njësive të kërkim-studimit në tërësi, si dhe respektimin e statusit të personelit shkencor;
- koordinon veprimtarinë e instituteve, qendrave e të njësive, në zbatim të programit të përgjithshëm e të atyre specifike;
- harmonizon projekt-programet vjetore e ato afatgjata të instituteve e njësive për t'ia paraqitur për miratim Kryesisë së ASHSH, si pjesë e programit të përgjithshëm;
- shqyrton e bashkërendon programet për projektet madhore shkencore, veçanërisht për ato me pjesëmarrje dhe karakter ndërnjësish, si dhe organizon punën për zbatimin e tyre pas miratimit;
- shqyrton projektbuxhetet e paraqitura nga çdo institut, qendër a njësi për t'ia përcjellë Kryesisë së ASHSH dhe Asamblesë, si pjesë të projektbuxhetit të ASHSH;
- bën shpërndarjen e buxhetit për institutet në bazë të përcaktimeve në buxhetin e ASHSH sipas vendimit të Kryesisë për ndarjen e fondit për njësitë, në përputhje me VKM nr. 821 datë 28 dhjetor 2023 *Për ngritjen dhe organizimin e njësive të përhershme të kërkim-studimit në albanologji pranë Akademisë së Shkencave në Republikën e Shqipërisë*; si dhe miraton detajimet e bëra nga çdo njësi për përdorimin e tij nga drejtuesi i institutit/ njësisë;
- përcakton kriteret e vlerësimit për personelin shkencor dhe shqyrton vlerësimet e drejtorit për veprimtarinë e tyre;
- jep mendime për projekt marrëveshjet që lidhen në nivel instituti dhe protokollet e bashkëpunimit në zbatim të marrëveshjeve të ASHSH me institucionin përkatës;
- shqyrton raportet vjetore të veprimtarive dhe ua përcjell ato Kryesisë së ASHSH dhe Asamblesë;

- shqyrton propozimet e instituteve dhe qendrave për ndryshime në organizimin e tyre, për përbërjen e tyre a të numrit të personelit, dhe i përcjell për miratim të mëtejshëm;
- harmonizon rregulloret e brendshme që lidhen me funksionimin specifik të instituteve, në përputhje me ato të përgjithshme e me këtë Statut;
- i propozon Kryesisë së ASHSH ngritjen e komisionit të etikës në kërkimin shkencor, si dhe të komisioneve të tjera që lidhen me veprimtarinë e instituteve;
- jep pëlqimin për ndryshimet në Statut që lidhen me funksionimin e instituteve dhe qendrave, si dhe për rregulloret në tërësi;
- shqyrton e bashkërendon propozimet e kërkesat e instituteve për organizimin e pjesëmarrjen e tyre e të personelit shkencor në programet e ciklit të dytë e të tretë të studimeve (pas)universitare.

VII VEPRIMTARITË KRYESORE

Neni 67 Botimet e Akademisë

Akademia e Shkencave, si ent botues, publikon revista periodike, si dhe veprat më të rëndësishme në fushën e shkencës të akademikëve apo të personaliteteve të fushave përkatëse.

Politika vjetore e botimeve miratohet në Asamble, si pjesë kryesore e programit dhe e buxhetit të saj vjetor, ndërsa realizimi i saj bëhet nga Këshilli i Botimeve, i cili përbëhet nga anëtarë të ASH-së e nga përfaqësues të institucioneve kryesore dhe drejtohet nga Kryetari i ASH-së. Ngritja e funksionimi i Këshillit të Botimeve, përcaktohen me rregullore të veçantë.

Përgjegjësinë e realizimit të botimeve periodike e kanë seksionet përkatëse. Për këtë pranë tyre ngrihet redaksia për çdo titull botimi (revistë, buletin). Redaksia përbëhet nga akademikë të fushës, specialistë-përfaqësues të institucioneve kërkimore dhe drejtohet nga kryetari i Seksionit, në cilësinë e kryeredaktorit. Kriteret për botimet dhe procedurat e pranimi përcaktohen në rregulloren përkatëse.

Akademia e Shkencave boton edhe materiale promovuese e pune, për pasqyrimin e aktiviteteve të saj, si konferenca, seminare, projekte, etj., si dhe materiale popullarizuese të Akademisë dhe përmbledhje studimesh e arritjesh shkencore, me miratimin e Kryesisë.

Çdo anëtar i Akademisë ka të drejtën të botojë me përparësi punimet e veta dhe rezultatet e punës kërkimore në periodikët e ASH-së e në botimet e saj, sipas kriterëve të vendosura për botim, si dhe të propozojë përfshirjen në programet vjetore të ASH-së të botimeve të caktuara nga fushat përkatëse.

Neni 68

Konferencat, kongreset

Për promovimin e kërkimit shkencor, si dhe për vlerësimin më të mirë të arritjeve e problemeve që shoqërojnë atë, ASH organizon konferenca, kongrese e seminare dhe merr pjesë aktive në to.

Organizimi i tyre është pjesë kryesore e programit vjetor të ASH-së. Ato zhvillohen nën logon e ASH-së, me mbështetjen e Kryesisë. Përgjegjësinë për organizimin e seminareve e kanë komisionet, ndërsa për konferencat dhe për kongreset seksionet ose grup-seksionet.

Propozimet për programimin e tyre bëhen nga çdo akademik, komision apo seksion, mbi bazën e të cilit bëhet programi vjetor. Për organizimin e aktiviteteve të tilla gjatë vitit, jashtë programit, vendos Kryesia me propozimin e një komisioni apo seksioni.

ASH ndjek dhe merr pjesë me përparësi në aktivitetet e ngjashme jashtë vendit. Pjesëmarrësit në to vendosen nga Kryesia, me propozim të seksioneve, duke u dhënë përparësi pjesëmarrësve me referime e kumtesa, anëtarë të ASH-së, ARSH-së ose kërkues pranë institucioneve kryesore.

Neni 69

Vlerësimet dhe çmimet shkencore

Për nxitjen e kërkimit shkencor, për vlerësimin e kërkuesve të rinj dhe karrierave më të suksesshme në vend, ASH jep vlerësime e çmime shkencore, bazuar në punimet, studimet dhe projektet shkencore të evidentuara nëpërmjet botimeve ose gjatë referimeve në konferencat e kongreset e ASH-së.

Llojet, kriteret e procedurat në dhënien e tyre përcaktohen në rregulloren përkatëse.

Neni 70

Këshilli Ndërakademik i Gjuhës Shqipe

Për realizimin e detyrave të parashikuara në pikat 3,16,18 të nenit 4 të ligjit të ASH-së, pranë Akademisë së Shkencave funksionon Këshilli Ndërakademik i Gjuhës Shqipe, sipas rregullores përkatëse.

Neni 71

Përfaqësimi

ASH përfaqësohet në organizma ndërakademikë, këshilla, komisione, borde me anëtarë të rekomanduar prej saj. Përfaqësuesit e përhershëm propozohen nga Kryesia e miratohen nga Asambleja, përfaqësuesit në komisione, borde përcaktohen nga Kryesia në konsultim me seksionet, ndërsa ekspertët i cakton Seksioni. Kryetari ose Kryesia, përcakton përfaqësues zëvendësues në rast mungese të përkohshme.

Neni 72
Bashkëpunimi ndërakademik

Në zbatim të funksioneve të saj, të parashikuara në pikat 9,10 të nenit 4, ASH lidh marrëveshje bashkëpunimi me akademitë simotra, me organizma akademikë, institucione të karakterit shkencor brenda e jashtë vendit, si dhe bëhet pjesëtare e organizmave të ndryshëm që kanë këtë qëllim.

Marrëveshjet që lidhen me akademitë, me organizma a me grupime akademike, miratohen nga Asambleja. Në raste të veçanta Kryesia mund të lidhë paraprakisht marrëveshje e, më pas, të kërkojë ratifikimin e saj.

Për marrëveshjet e tjera vendos Kryesia, por për to njoftohet Asambleja. Edhe anëtarësimi i ASH-së në organizma ndërkombëtarë bëhet nga Kryesia apo Kryetari me pëlqimin e Asamblesë.

VIII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 73
Marrëdhëniet me institucionet shtetërore

1. Akademia, brenda tremujorit të parë të çdo viti, dërgon pranë Këshillit të Ministrave dhe komisionit kuvendor përkatës raportin e veprimtarisë vjetore të punës së saj për vitin paraardhës.
2. Në mbledhjen e saj vjetore për miratimin e programit të punës së Akademisë, ftohen të marrin pjesë përfaqësues të institucioneve kryesore të kërkimit dhe të Këshillit të Ministrave.
3. Një herë në vit organizohet dialogu shkencë–politikë, ndërmjet Akademisë së Shkencave dhe Këshillit të Ministrave, sipas një marrëveshjeje dypalëshe.
4. Kryesia përcakton problemet e kërkesat që do të shtrohen prej saj në dialogun me KM në bazë të propozimeve paraprake të çdo anëtarë të Akademisë, të grupuara më tej prej komisioneve e seksioneve sipas rëndësisë e përparësisë.

Neni 74
Mbështetja administrative dhe financiare

1. Kryesia e Akademisë, në ushtrimin e veprimtarisë së saj dhe për kryerjen e shërbimeve administrative, profesionale e teknike, mbështetet nga administrata e Akademisë.
2. Kancelari është autoriteti më i lartë administrativ i Akademisë, i cili përgjigjet për organizimin dhe mirëfunksionimin e administratës, në zbatim të vendimeve të Asamblesë dhe të Kryesisë.

3. Zgjedhja e kancelarit dhe punonjësve të administratës rregullohet sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin civil, duke e njësuar pozicionin e kancelarit me atë të Sekretarit të Përgjithshëm në ministri.
4. Kancelari kryen këto funksione:
 - a) harton projektbuxhetin vjetor mbi bazën e propozimeve të seksioneve dhe mbështetur në strategjinë e zhvillimit të institucionit;
 - b) drejton procedurat e prokurimit të buxhetit dhe është urdhërues i tij;
 - c) ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të institucionit;
 - ç) i paraqet Asamblesë raportin vjetor mbi veprimtarinë financiare të institucionit;
 - d) detyra të tjera të kancelarit përcaktohen në statut dhe në rregulloret e institucionit, që miratohen nga Kryesia.
5. Struktura, organika dhe niveli i pagave për administratën përcaktohen nga Asambleja me propozim të Kryesisë, e cila ia paraqet Kuvendit për miratim.

Neni 75 **Financimi**

1. Akademia është institucion buxhetor.
2. Veprimtaria e saj financohet nga:
 - a) buxheti i shtetit;
 - b) shërbimet tekniko-shkencore, që kryen për persona juridikë e fizikë jashtë sistemit të saj;
 - c) aplikimet, projektet, dhuratat, subvencionet e sponsorizimet, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Të ardhurat nga pikat “b” dhe “c”, të këtij neni, nuk e zvogëlojnë buxhetin e përgjithshëm, sipas pikës “a” dhe ato përdoren sipas rregullores së brendshme të Akademisë.
4. Projekt-buxheti i Akademisë i dërgohet për miratim Kuvendit.

Neni 76 **Mbështetja financiare për anëtarësinë**

Anëtarët e Akademisë nuk marrin pagë për shkak të anëtarësimit.

Anëtarët e Asamblesë me titull “akademik” dhe “akademik i asociuar” marrin shpërblim për titull sipas përcaktimeve në aktet nënligjore përkatëse. Shpërblimi për anëtarët me titull “akademik emeritus” njësohet me atë për titullin “akademik”.*

* Ndryshuar me Vendimin e Asamblesë nr.47, dt.21.07.2021.

Ata nuk marrin honorar shtesë për aktivizimin në kryerjen e detyrimeve bazë që vijnë nga ky statut. Pjesëmarrja në mbledhjet e Asamblesë, të seksionit, komisionit, në konferenca e në kongrese, janë pjesë e detyrimeve si anëtarë.

Të vetmit funksionarë me kohë të plotë janë anëtarët e Kryesisë, të cilët për këtë marrin pagë ose honorar deri 25% të pagës së përcaktuar sipas pikës 5, neni 74 i këtij statuti.

Për detyra shtesë që i ngarkohen si: për përfaqësimin e ASH-së në këshilla apo borde; për pjesëmarrje në njëjési kërkimore-studimore; komisione të posaçme etj., ata trajtohen si anëtarët e tjerë, sipas akteve që rregullojnë funksionimin e tyre.

Anëtarët e jashtëm mbështeten nga ASH për mbulimin e shpenzimeve, sa herë që ftohen e shprehin interes për të marrë pjesë në aktivitetet kryesore e mbledhjet e rregullta të ASH-së, si dhe kur ngarkohen me detyra konkrete pranë njësive e komisioneve të posaçme, apo kur ftohen për të zhvilluar një aktivitet të caktuar në fushën e tyre.

Anëtarët e nderit mbështeten financiarisht sa herë që kërkohet ndihmesa tyre për çështje të caktuara, si dhe kur pjesëmarrja e tyre është e domosdoshme në aktivitetet përkatëse.

Neni 77

Biblioteka Shkencore dhe libri akademik

Biblioteka është njësi bazë dhe qendër e informimit shkencor në Shqipëri, përmes shërbimeve të saj si ruajtja e koleksioneve, veprimtarive promovuese, anëtarësimi për shërbime dhe informimi. Biblioteka është e hapur ndaj kërkuesve shkencorë dhe studentëve. Ajo u mundëson përdoruesve, instrumente dhe shërbime të karakterit digjital dhe jo vetëm në mbështetje të kërkimit dhe studimit shkencor. Biblioteka boton buletin periodik të hyrjeve të reja dhe është qendër e organizimit të aktiviteteve të ndryshme shkencore.

Libri akademik është një hapësirë dedikuar promovimit, ekspozimit dhe ruajtjes së botimeve të Akademisë së Shkencave.

Funksionimi i Bibliotekës Shkencore dhe Librit Akademik, bëhet mbështetur në rregulloren e veçantë, të miratuar nga Kryesia.

Neni 78

Muzetë akademikë

Për të dokumentuar, promovuar dhe transmetuar trashëgiminë akademike, pranë Akademisë së Shkencave funksionojnë muze, që lidhen me jetën dhe veprimtarinë e akademikëve më të shquar, të ngritura në përputhje me legjislacionin përkatës, për trashëgiminë kulturore dhe muzetë.

Neni 79

Ceremoniali

Për organizimin dinjitoz dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve kryesore të ASH-së, ku përfshihen: mbledhjet e Asamblesë, takimet zyrtare apo të punës, të natyrës dypalëshe, ceremonitë e pranimi në Akademi të anëtarëve të zgjedhur si: Akademik, Akademik i Asociuar, Emeritus, Nderi i Jashtëm, si edhe ceremonitë e dhënies së çmimeve dhe nderimeve ndaj personaliteteve të ndryshme vendase dhe të huaja, ASH pajiset me një Ceremonial të posaçëm nëpërmjet miratimit nga Kryesia të një rregulloreje të veçantë.

Neni 80*

Dispozita kalimtare

Zgjedhjet e drejtuesve të instituteve dhe të qendrave kërkimore-shkencore sipas këtij statuti bëhen në fund të vitit 2024.

Këshillat shkencorë të përkohshëm deri në zgjedhjet e reja dhe drejtorët caktohen nga Kryesia e ASHSH.

Anëtarët e zgjedhur të këshillave shkencorë të derimëtanishëm vazhdojnë të jenë anëtarë të këshillave shkencorë përkatës.

Neni 81

Shfuqizime

Statuti i miratuar nga Asambleja e ASH-së me nr. prot.319, datë 10.12.2008, shfuqizohet.

Neni 82

Hyrja në fuqi

Ky statut hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më shkurt 2024

* Shfuqizohet ekzistuesi, formulohet sipas VA nr. 1., datë 9.01.2024.

Aneksi 1

STEMA DHE LOGO

Stema e Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë është si më poshtë:



Në formë rrethore shkruhet logo: **AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË, 1972, TIRANË**

Aneksi 2

Kriteret specifike dhe procedurat e vlerësimit të tyre për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Akademisë

Kritere të përgjithshme

Kandidatët që konkurrojnë për anëtarë të Asamblesë (akademikë, akademikë të asociuar), duhet të plotësojnë paraprakisht kriteret normative të përcaktuara në ligjin e ASH-së dhe në statut, që lidhen me integritetin e figurës, titullin, moshën, vendbanimin dhe origjinën.

Te kandidatët për anëtarë të jashtëm kushti për të pasur titullin “profesor”, zëvendësohet me gradën "PhD" (a të njëvlershëm me to).

Kandidatët nga fusha e krijimtarisë mund të përjashtohen nga kriteri për titull, ndërsa kandidatët për anëtarë nderi e anëtarët jo shtetas shqiptarë, përjashtohen nga verifikimet e parashikuara në ligjet tona për integritetin e figurës.

1. Anëtarët e Asamblesë (akademikë, akademikë të asociuar)

1.1 Kriteret specifike

Kandidati që konkurren për të qenë anëtar i Asamblesë, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Të ketë fituar titullin *profesor* si rregull prej 10 vjetësh, por në çdo rast jo më pak se 8 vjet, në një institucion akademik-universitar; me një kontribut të veçantë me ndikim të gjithëpranuar në fushën përkatëse, si para edhe pas marrjes së titullit *profesor*.*
- Të ketë botuar vepra shkencore jashtë vendit me indeksim shkencor apo një numër të konsiderueshëm artikujsh, një pjesë të botuar në revista të indeksuara të BE-së, OECD-së, G-20-ës, me bord editorial dhe /ose me faktor impakti, të rankuara nga listat e njohura ndërkombëtarisht për indeksim shkencor, si *Journal Citations Reports – Clarivate Analytics* ose *Scopus (Q1 e Q2)*; *Thomson Reuters*, si dhe në revista shkencore të institucioneve të specializuara të fushës.
- Të ketë referime të shumta shkencore, të botuara ose të certifikuara në veprimtari shkencore kombëtare, ndërkombëtare, një pjesë të zhvilluara në vendet e BE-së, OECD-s, G-20-ës, e të botuara në *Proceeding* të indeksuara me kod ISBN ose ISSN.
- Të jetë i punësuar (a të ketë qenë) me kohë të plotë apo të pjesshme në një institucion universitar ose kërkimor-shkencor në RSH, për një periudhë mbi 20-vjeçare.
- Të ketë udhëhequr me sukses për gradën “doktor i shkencave” një numër kërkuesish të rinj.
- Të ketë drejtuar për një periudhë të konsiderueshme një njësi të kërkimit pranë institucioneve të arsimit të lartë a pranë instituteve të kërkimit.

* Ndryshuar me Vendimin e Asamblesë nr.47, dt.21.07.2021.

- Kandidati vlerësohet edhe për anëtarësinë në komitete, redaksi dhe borde shkencore; për pjesëmarrje në projekte shkencore kombëtare në nivel drejtuesi ose koordinuesi dhe për vlerësim të tyre; për drejtim të komiteteve organizuese të konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

1.2 Procedurat e vlerësimit të kandidaturave dhe kriterëve specifike

- Kriteri i kohës së fitimit të titullit vlerësohet paraprakisht nga komisioni teknik, sipas nenit 7, pika 6 e Statutit të ASH. Kandidati që nuk plotëson kushtin e 8 (tetë) vjetëve nga fitimi i titullit *profesor* nuk kualifikohet. Për kandidatët e tjerë veprohet si më poshtë.*
- Njësia bazë universitare a kërkimore ku punon kandidati, ose ka ushtruar aktivitetin kryesor, jep një vlerësim të motivuar për plotësimin ose jo të kriterëve specifike nga kandidati, ndërsa senati apo këshilli shkencor, ku kandidati ka fituar titullin, shprehet me votë konsultative për mbështetjen ose jo të kandidaturës.
- Komisioni përkatës pranë ASH-së bën vlerësimin e shkallës së plotësimit të kriterëve të mësipërme, duke u shprehur në mënyrë të detajuar për secilën nga rubrikat dhe pasqyruar më vete, aktivitetin pas marrjes së titullit “Profesor”.
- Në rast të mosplotësimit të një ose disa prej këtyre kërkesave, në masë të krahasueshme me ato të fitimit të titullit “profesor”, Komisioni mund të rekomandojë mosmbështetjen e kandidaturës.
- Vlerësimet e njësisë, komisionit dhe mendimi i senatit (këshillit) i përcillen Seksionit, i cili vazhdon procedurën, sipas statutit, për kandidatët që plotësojnë kriteret.
- Vlerësimet e njësisë bazë e të komisionit të ASH-së kanë karakter teknik, në verifikimin e plotësimit formal të kriterëve, si: numri i punimeve, indeksimi i revistave a enteve botuese, numri i citimeve etj.
- Ndërsa për vlerën e rëndësinë e aktivitetit në tërësi, si dhe për integritetin e tyre profesional të kandidatëve shprehet senati (këshilli shkencor) dhe Seksioni i ASH-së.

2. Anëtarët e Asamblesë nga radhët e personaliteteve nga fusha e krijimtarisë artistike, kulturës dhe jetës sociale

2.1 Kriteret specifike

Kandidatët e propozuar për anëtarë nga radhët e personaliteteve prej fushës së krijimtarisë artistike, kulturës dhe jetës sociale duhet të jenë krijues e personalitete me njohje kombëtare e ndërkombëtare dhe të kenë:

* Ndryshuar me Vendimin e Asamblesë nr.47, dt. 21.07.2021.

1. krijimtari artistike të njohur, publikuar e vlerësuar gjerësisht në fushat e artit (letërsi, muzikë, arte pamore etj.);
2. fituar çmime dhe vlerësime të larta publike nga institucionet e vendit dhe të njohur ndërkombëtarisht për krijimtarinë e tyre të botuar, interpretuar dhe publikuar, si dhe për veprimtarinë e tyre publike si personalitete të fushave të artit e të jetës sociale;
3. disa vepra artistike (të përkthyer apo të interpretuara), brenda e jashtë vendit, të cilat për rëndësinë dhe vlerat e tyre spikasin dhe provojnë talentin dhe personalitetin krijues të kandidatit, vepra të cilat të jenë bërë edhe objekt i vlerësimeve pozitive të mendimit intelektual në Shqipëri e jashtë saj;
4. reputacion publik pozitiv, që lidhet me angazhimin e tij në jetën artistike, kulturore e sociale të vendit.

2.2 Procedurat e vlerësimit

Vlerësimi i kriterëve për ta bëhet drejtpërsëdrejti në seksionin përkatës.

3. “Akademikët e asociuar” që konkurrojnë për “akademikë”

Kur kandidati për “akademik” është “akademik i asociuar”, atëherë vlerësohet posaçërisht aktiviteti i kandidatit pas fitimit të titullit “akademik i asociuar” bazuar në kriteret e mësipërme. Vlerësimi bëhet drejtpërdrejt nga komisioni dhe seksioni.

4. Anëtarët e jashtëm

4.1 Kriteret specifike

Kandidati që konkurren a propozohet për anëtar të jashtëm të Akademisë, duhet:

- 1) Të ketë titullin “profesor” apo gradën "PhD", të fituar këtë të fundit prej të paktën 15 vjetësh në fushat teknike sociale dhe prej 10 vjetësh në shkencat e natyrës.
- 2) Të jetë punonjës akademik pranë një shkolle të lartë a një qendre kërkimore me reputacion të mirë ndërkombëtar.
- 3) Të ketë një aktivitet të dalluar shkencor me mbi 20 artikuj shkencor në revista të indeksuara a me faktor impakti të lartë.
- 4) Të ketë botime shkencore të cituara e një numër të konsiderueshëm referimesh në veprimtari shkencore ndërkombëtare.

4.2 Procedurat e vlerësimit

Vlerësimi i kriterëve të mësipërme bëhet nga komisioni përkatës mbështetur në relacionet e argumentuara të dy specialistëve të ngarkuar prej tij dhe mbi vlerësimin e titullarit të njësisë bazë ku punon kandidati dhe të departamentit përkatës në universitetin publik.

Vlerësimi i komisionit i kalon seksionit përkatës për më tej.

5. Anëtarët e nderit

5.1 Kriteret specifike

Kandidatët e propozuar për anëtarë nderi, të jenë figura të shquara në fushën e vet me reputacion ndërkombëtar e të kenë kontribuar:

- a) drejtpërdrejt në fushën e albanologjisë me aktivitetin e punimet e tyre;
- b) të kenë punuar a bashkëpunuar me qendra albanologjike në vendin e tyre apo me qendrat e këtij lloji në Shqipëri;
- c) të kenë ndikuar me bashkëpunim të drejtpërdrejtë për zhvillimin e shkencës në një fushë të caktuar në vendin tonë nëpërmjet udhëheqjeve apo këshillimit e asistimit;
- d) të ketë ndikuar në promovimin e shkencës shqiptare e të vendit në qarqet akademike e më gjerë.

5.2 Procedurat e vlerësimit

Propozuesi i kandidatit për “anëtar nderi” paraqet një relacion të arsyetuar për plotësimin e vlerësimit e disa prej kriterëve të mësipërme, seksioni përkatës kërkon mendimin e akademikëve të fushës e të dy njësive përkatëse ndër ato pranë universiteteve e instituteve kryesore të vendit.

Në bazë të tyre seksioni shpreh mbështetjen për kandidimin.

Aneksi 3

Procedurat e votimit dhe e përcaktimit të fituesit për zgjedhjen e Kryetarit, anëtarëve të Kryesisë dhe të anëtarëve të Akademisë

Përcaktime:

Me mbi 50% të votave d.t.th. se numri i votave “pro” duhet të jetë më i madh se $\frac{1}{2}$ e numrit (të anëtarëve gjithsej minus numrin e anëtarëve Emeritus që nuk marrin pjesë në votim).

Me mbi 50% të votave gjithsej d.t.th. se numri i votave “pro” duhet të jetë më i madh se $\frac{1}{2}$ e numrit të pjesëmarrësve në votim.

Zgjedhja e Kryetarit dhe anëtarit të Kryesisë

Në rastin kur për funksionin përkatës ka një kandidat.

Në këtë rast votohet me një raund ku çdo pjesëmarrës shprehet me **Po** ose **Jo** për kandidaturën. Kandidati shpallet fitues në rast se merr “pro” mbi 50% të votave.

Në rastin me dy kandidatë

Në këtë rast votohet me një fletë votimi që përmban dy raunde votimi.

Në të parin votohet se cili nga kandidatët është më i mbështetur duke vendosur **X** përbri emrit të tij.

Raundi i parë

Emri, mbiemri	Po
Kandidati 1	X
Kandidati 2	----

Në raundin e dytë, çdo anëtar voton për secilin kandidat me **Po** ose **Jo**, sikur ai të ishte kandidat i vetëm, duke vendosur shenjën **X** përbri opsionit të zgjedhur, pra çdo anëtar ka dy vota.

Raundi i dytë

Emri , mbiemri	Po	Jo
Kandidati 1	X	

Emri , mbiemri	Po	Jo
Kandidati 2	X	

Kandidat fitues quhet ai që ka fituar mbi 50% të votave “pro” në raundin e parë, ose ai prej kandidatëve, duke filluar nga i pari, që në raundin e dytë ka fituar “pro” mbi 50% të votave gjithsej.

Në rastin me tre kandidatë e më shumë

Votohet me një fletë votimi e përlllogaritjet bëhen në disa faza.

Çdo anëtar rendit kandidatët sipas preferencës duke vendosur shenjën X përbri emrit të kandidatit, nën numrin rendor sipas të cilit dëshiron të rendis kandidatin p.sh.

Emri mbiemri	1	2	3
Kandidati 1		x	
Kandidati 2	x		
Kandidati 3			X

Fleta tregon se votuesi ka bërë këtë renditje: Kandidati 2, Kandidati 1, Kandidati 3

Kandidatët renditen sipas numrit të vendeve të para të fituara., të cilat konsiderohen vota “pro”. N.q.s. kandidati i parë ka fituar më shumë se 50% të votave shpallet fitues. Në të kundërt eliminohet kandidati i tretë, dhe shihet cilët nga dy kandidatët e mbetur ka fituar më shumë vende të para në fletët e votimit gjithsej.

I pari shpallet fitues me kusht që numri i votave (vendeve të para) të jetë më i madh se 50% e numrit të votave gjithsej.

Zgjedhja e anëtarëve të rinj

Për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Asamblesë e ata të jashtëm ndiqet e njëjta procedurë dhe mënyrë për llogaritje si për anëtarët e Kryesisë, me ndryshimin, që në raundin e dytë për anëtarët e rinj fituesi duhet të ketë marrë mbi 50 % të votave.

Për kandidatët që kandidojnë direkt për “Akademik” në raundin e parë, duhet të kenë marrë jo më pak se $\frac{2}{3}$ e votave, ku si numër votash merret ai i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij aneksi.

Aneksi 4

Komisionet dhe emërtimi i tyre

Pranë ASH-së ngrihen këto Komisione Shkencore:

- *Komisioni i arkeologjisë*
- *Komisioni i historisë*
- *Komisioni i gjuhësisë dhe i letërsisë*
- *Komisioni i antropologjisë dhe trashëgimisë kulturore*
- *Komisioni i arteve*
- *Komisioni i ekonomisë, shkencave sociale dhe juridike*
- *Komisioni i matematikës, informatikës*
- *Komisioni i fizikës, kimisë*
- *Komisioni i inxhinierisë*
- *Komisioni i mjekësisë*
- *Komisioni i biologjisë, bujqësisë, veterinarisë*